



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 81 AKTI

Nr. 187 VENDIMI

Tiranë, më 24.07.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Pamela Qirko	Anëtare
Genta Tafa (Bungo)	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra, më datë 22.07.2019, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Z. Elvin Gokaj, prokuror/drejtues në Prokurorinë e Apelit Shkodër, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE : **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E, Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, (referuar më poshtë “Kushtetuta”).

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (referuar më poshtë “ligji nr. 84/2016”);

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen duke u bazuar në të trija kriteret e vlerësimit, atë pasuror, të figurës dhe vlerësimin profesional, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. **Elvin B. Gokaj**, ushtron detyrën e prokurorit/drejtues në Prokurorinë e Apelit Shkodër, detyrë të cilën e ka filluar në muajin qershor të vitit 2014 dhe, në bazë të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Ai i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur më datë 15.01.2018 në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 24.01.2018, u caktua me mirëkuptim si kryesuese, zonja Xhensila Pine, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin Elvin Gokaj.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Prokuroria e Përgjithshme, si organ i vlerësimit të aftësive profesionale.

Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. *** prot., datë 08.01.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar se:

- 1) *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- 2) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- 3) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- 4) *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- 5) *nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 02.11.2017, në përputhje me nenin 39 të ligjit 84/2016, të deklasifikuar me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 20.02.2018, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit*, z. Elvin Gokaj.

Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 29.01.2018.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 23.05.2019 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t`u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më datë 07.06.2019.

Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore. Më datë 17.06.2019, është administruar denoncimi i shtetases D. M., ardhur me email më datë 15.06.2019. Me vendim nr. 4, datë 17.06.2019, trupi gjykues vendosi të rihapë hetimin administrativ dhe të njoftojë për këtë subjektin. Me vendimin nr. 5, datë 10.07.2019, u vendos përfundimi i hetimit administrativ, si dhe njoftimi i subjektit për njohjen me rezultatet shtesë të këtij hetimi.

Subjekti i rivlerësimit ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më datë 18.07.2019. Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, më datë 19.07.2019.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 22.07.2019, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, duke shprehur opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Elvin Gokaj ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur, kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka zbatuar me përpikmëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit;
- f) deklaratimet e personave të tjerë të lidhur.

Në deklaratën e pasurisë “Vetting”, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, subjekti deklaroi këto pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme:

- 1. Apartament banimi, me sipërfaqe 57 m²**, në Shkodër, me numër pasurie ***, volum ***, faqe ***, zona kadastrale ***.

Burimi i deklaruar i krijimit: Burimi është dhurim me aktdhurimi nr. ***, datë 11.02.2010 me origjinë “Shoqatën e të përndjekurve politikë”.

Subjekti ka vënë në dispozicion:

- Certifikatë për vërtetim pronësie të apartamentit 57 m², në rr. “****”, me numër pasurie ***, volum ***, faqe ***, zona kadastrale ***, lëshuar më datë 04.06.2010, si dhe hartën treguese të regjistrimit në emër të Elvin Gokaj;
- Aktdhurimi i pasurisë së paluajtshme apartament, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.02.2010;
- Certifikatë për vërtetim pronësie të apartamentit 57 m², në rr. “****”, me numër pasurie ***, volum ***, faqe ***, zona kadastrale ***, lëshuar sipas kërkesës nga të interesuarit më datë 11.09.2006 dhe hartën treguese e regjistrimit në emër të A., B., S. dhe K. G.

Hetimi i kryer nga Komisioni

- Shkresë, nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar ZVRPP-së Shkodër; ZVRPP-ja Shkodër me shkresën nr. ***, datë 02.02.2018 konfirmon këtë pasuri.
- Shkresë, nr. *** prot., datë 03.04.2018, drejtuar noterit publik O. K.;
- Shkresë, nr. *** prot., datë 19.04.2018, drejtuar noterit publik A. S.;
- Shkresë, nr. *** prot., datë 22.10.2018, drejtuar noterit publik M. L. Gj., në lidhje me kontratën e qirasë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.10.2013.

Arsyetimi ligjor

1. Në datën 11.02.2010 me akt dhurimi nr. ***, familjarët e subjektit të rivlerësimit i kanë dhuruar atij një apartament banimi, me sipërfaqe 57 m², ndodhur në rrugën “****”, Shkodër. Këtë apartament familjarët e tij e kanë përfutuar nga statusi si ish-e përndjekur politike e së ndjerës, gjyshes së subjektit të rivlerësimit, znj. A. G.
Ky apartament bazuar në shkresën e ZVRPP-së Shkodër rezulton se është i regjistruar në emër të subjektit.

Komisioni vlerëson se subjekti ka qenë i saktë në deklarinimin e tij. Të dhënat e referuara prej tij konfirmohen edhe nga dokumentacioni shkresor i institucioneve përkatëse. Nga hetimi administrativ nuk rezultojnë të dhëna të paqarta apo dyshime në lidhje me këtë pasuri.

2. Në bazë të kontratës së qirasë të datës 16.10.2013 nr. *** rep., datë 16.10.2013, ky apartament rezulton t'i jetë dhënë me qira z. F. N., me afat 3-vjeçar (duke filluar nga data 01.08.2013 deri në datën 31.07.2016), kundrejt qirasë mujore prej 12.000 lekë në muaj.

Komisioni hetoi në lidhje me këtë qiradhënie, duke qenë se nuk janë deklaruar asnjëherë të ardhura nga qiraja nga ana e subjektit. Pas shqyrtimit të deklarimeve të subjektit, si dhe dokumentacionit të administruar¹ rezulton se qiraja mujore përdoret për mirëmbajtje të kësaj banese dhe nuk është përfutuar asnjëherë nga subjekti. Në këto kushte, shumat e llogaritur mbi bazën e kontratës së qirasë nuk përfshihet në të ardhurat e subjektit.

¹ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.10.2014 dhe aktmarrëveshje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.12.2016.

➤ Në përfundim të hetimit, rezulton se subjekti ka qenë i saktë në deklarin e tij.

2. Apartament banimi 76 m², në Durrës, i regjistruar me numër pasurie ***, volum ***, faqe ***, zona kadastrale ***.

Burimi i deklaruar i krijimit: Kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes ndër vite.

Subjekti ka vënë në dispozicion:

- Certifikatë për vërtetim pronësie të apartamentit 76 m², ndodhur në Durrës, regjistruar me numër pasurie ***, volum ***, faqe ***, zona kadastrale ***, lëshuar më datë 17.06.2014, shoqëruar me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme;
- Kontratë shitje apartamenti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.05.2014, apartament me sipërfaqe 76 m², me vlerë 30.000 euro, lidhur me me shoqërinë ndërtimore “****” sh.p.k., faturë arkëtimi nr. ***, datë 24.06.2015;
- Certifikatë për vërtetim pronësie të apartamentit 76 m², ndodhur në Durrës, regjistruar me numër pasurie ***, volum ***, faqe ***, zona kadastrale ***, lëshuar sipas kërkesës nga të interesuarit më datë 28.12.2012 dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme në emër të “****” sh.p.k.;
- Mandatarkëtimi dore, pa numër, datë 30.04.2009, nga Elvin Gokaj për shumën 20.000 euro paguar për apartament 1+1, kati ***, nga jugu, ***, rr. “****”;
- Mandatarkëtimi dore, pa numër, datë 30.05.2014, nga Elvin Gokaj për shumën 10.000 euro “paguar për likuidim apartamenti”;
- Mandat pagese nga “Banka Credins”, tërheqje *cash* në llogarinë e Elvin Gokaj, shuma 11.601 euro, më datë 10.12.2014;
- Kontratë sipërmarrjeje, pa noter, midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe porositësit Elvin Gokaj më 30.04.2009 për apartament me sipërfaqe 84.5 m² në Durrës për shumën 30.000 euro, nga të cilat në këstin e parë do të paguhen 20.000 euro.

Hetimi i kryer nga Komisioni

- Shkresë nr. *** prot., datë 25.05.2018, drejtuar ZVRPP-së Durrës; ZVRPP-ja Durrës, me shkresën nr. ***, datë 04.06.2018, konfirmon këtë pasuri.
- Shkresë, nr. *** prot., datë 03.04.2018, drejtuar noterit publik A. S.;
- Shkresë, nr. *** prot., datë 19.04.2018, drejtuar noterit publik A. S.;
- Shkresë, nr. *** prot., datë 09.05.2018, drejtuar noterit publik A. S.;
- Shkresë, nr. *** prot., datë 07.06.2018, drejtuar 16 bankave për informacion mbi çdo veprimtari bankare të personit tjetër të lidhur, E. N., deri më 10.12.2014;
- Shkresë, nr. *** prot., datë 01.08.2018, drejtuar ILDKPKI-së, për të vënë në dispozicion deklarinmet periodike të personit tjetër të lidhur, E. N.;
ILDKPKI-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 03.08.2018, i vë në dispozicion Komisionit deklarinmet periodike të personit të tjetër të lidhur, E. N., për periudhën 2003 – 2013.
- Shkresë, nr. *** prot., datë 18.07.2018, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës; Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, me shkresën nr. *** prot (E.A), datë 27.07.2018, i ka vënë në dispozicion Komisionit informacionin e kërkuar.
- Shkresë, nr. *** prot., datë 28.09.2018, drejtuar Gjykatës së Apelit Durrës;

Gjykata e Apelit Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 01.10.2018, i ka vënë në dispozicion Komisionit informacionin e kërkuar.

Arsyetimi ligjor

a. Subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratë sipërmarrjeje me firmën “***” sh.p.k. më datë 30.04.2009 për porositjen e një apartamenti me sipërfaqe 84.5 m². Sipas kësaj kontrate, porositësi (subjekti) duhet të paguajë shumën prej 20. 000 euro me lidhjen e kësaj kontrate. Kjo pagesë është vërtetuar nga subjekti me mandatarkëtimin datë 30.04.2009, me përshkrimin “nga Elvin Gokaj për shumën 20.000 euro paguar për apartament 1+1, kati ***, nga jugu, ***, rr. “****”.

Më datë 30.05.2014 subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., për këtë apartament, ku sipërfaqja e tij rezulton 76 m², duke kryer edhe pagesën në shumën 10.000 euro.

Për këtë pasuri, Komisioni ka konstatuar se ka mospërputhje midis sipërfaqes së apartamentit të parashikuar në kontratën e sipërmarrjes me atë të kontratës së shitjes. Në lidhje me këtë konstatim, pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka sqaruar se kjo diferencë kishte ardhur si pasojë e përfshirjes në kontratën e sipërmarrjes të sipërfaqeve të përbashkëta.

Shpjegimet e subjektit në lidhje me sipërfaqen rezultuan bindëse, dhe për rrjedhojë Komisioni vlerëson se ai ka qenë i saktë në deklaratimet e tij.

b. Komisioni hetoi për aftësitë paguese të subjektit për këstin prej 20. 000 euro, më datë 30.04.2009.

Në deklaratimin periodik të vitit 2009 subjekti ka deklaruar si burim për likuidimin e çmimit të apartamentit:

- mbyllje depozite në “Raiffeisen Bank” në datën 24.04.2009, në vlerë 1.048.600 lekë, si dhe
- gjendjen *cash* në vlerë 1.377.615 lekë nga bashkëshortja.

Subjekti ka deklaruar detyrime financiare në shumën 10.000 euro ndaj firmës *** (H. G.) datë 30.04.2009.

Referuar të dhënave nga “Raiffeisen Bank” konstatohet se në datë 24.04.2009 në llogarinë e pagës së subjektit është transferuar shuma 547.400 lekë nga llogaria depozitë nr. *** në ALL po në emër të tij.

Në datë 30.04.2009 gjendja e kësaj llogarie page ka qenë 668.000 lekë.

Gjithashtu nga llogaria depozitë është tërhequr *cash* në datë 24.04.2009 shuma prej 500.000 lekë.

Analiza Financiare

	Gj. 01.01.2009	Gj.30.04.2009
Cash në banesë	1377615	0
Subjekti		
Banka Raiffeisen	766	668000
Banka Raiffeisen depozita	1000000	0
Bashkëshortja		

	Banka Raiffeisen	4486	3986
	Banka Credins	39196	67338
	Totale	2422063	739324
	zvogëlim vl.monetare		1682739

Analiza financiare për 01.01.2009-30.04.2009

Përshkrimi	Vlera në Lek
Të ardhurat nga paga Sr 01.01.2009-30.04.2009	375512
Të ardhurat nga paga bashkëshortja 01.01.2009-30.04.2009	155142
Total mjete monetare të hyra	530654
Pagesat per shpenzime jetese 4 muaj deklaruar nga Sr . Pergj. Pyet.3	418510
Total shpenzime	418510
Ndryshim mj. Monetare cash në banese gj.01.01.2009-30.04.2009	1377615
Ndryshim mj. Monetare banke gj.01.01.2009-30.04.2009	305124
Mjete monetare të disponueshme (1)	1794883
Pagesa për blerje pasurie	3932400
Detyrime	1310800
Pasuri neto (2)	2621600
Balanca e fondeve (1-2)	-826717

Në përfundim ka rezultuar se subjekti ka patur mungesë të mjeteve financiare në shumën 826.717 lekë për pagimin e këstit prej 20.000 euro. Në lidhje me këtë rezultat, subjektit iu kalua barra e provës.

Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit një raport ekonomik datë 28.05.2019, të hartuar nga një ekspert kontabël i miratuar, sipas të cilit rezultoi se subjekti i ka patur mundësitë financiare për pagesën e këtij kësti. Pas shqyrtimit të detajuar të këtij raporti, Komisioni vlerëson se:

- Periudha e analizuar në këtë raport (01.01.2008-30.04.2009), nuk përkon me periudhën e marrë në analizë nga Komisioni (01.01.2009-30.04.2009);
- Nuk janë evidentuar dhe analizuar kursimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në datë 31.12.2008, duke shmangur të dhënat e DPV 2008, si dhe vetë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit për shpenzimet mesatare për jetesë (në përgjigje të pyetësorit nr.3).
- Shpenzimet mesatare mujore jetike në raportin ekonomik të mësipërm i janë referuar shpenzimeve mesatare mujore sipas komponentëve të konsumit dhe rajonit Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës (AMNJ) për vitin 2008 (rajonit qendror) dhe jo deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 3.

Nga shqyrtimi i të gjithë dokumentacionit të administruar, rezultoi se raporti financiar i dërguar nga subjekti i rivlerësimit, nuk jep një analizë të saktë të burimit të të ardhurave të

përdorura dhe mjaftueshmërisë financiare për likuidimin e shumës prej 20.000 euro në datë 30.04.2009.

Likuiditetet në nisje të analizës (01.01.2009) duhet të ishin marrë vlerat monetare *cash* 1.377.615 lekë (gjendje kursime nga viti 2008 në banesë, DPV 2008) dhe vlerat monetare në bankë 1.044.448 lekë (referuar dokumentacionit bankar në datë 01.01.2009). Mospasqyrimi i saktë i ngjarjeve financiare dhe vlerave monetare, referuar dokumentacionit ligjor vërtetues dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit ka çuar në një analizë jo të drejtë financiare dhe konkluzion jo të saktë dhe të besueshëm të raportit ekonomik, në lidhje me mjaftueshmërinë e subjektit të rivlerësimit për të paguar shumën prej 20.000 euro në datë 30.04.2009.

Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit është në pamjaftueshmëri financiare në shumën 826.717 lekë për pagimin e këstit të parë të këtij apartamenti.

c. Kësti i dytë i pagesës për blerjen e këtij apartamenti është paguar në datën e lidhjes së kontratës së shitblerjes. Për pagesën e këstit të dytë prej 10, 000 euro, më datë 30.05.2014, subjekti ka vënë në dispozicion mandatpagesën e datës 30.05.2014. Kjo shumë i është marrë hua shtetasit E. N., në datë 30.05.2014 me aktmarrëveshje, e cila nuk është nënshkruar përpara noterit publik.

Kthimi i huas z. E. N., nga subjekti i rivlerësimit është bërë në datën 10.12.2014 bazuar në aktin noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.12.2014. Nga verifikimi i llogarive të subjektit të rivlerësimit në “Credins Bank” rezulton se ai në datë 10.12.2014 të cilën ka tërhequr shumën prej 11, 601 euro. Nga analiza financiare e subjektit rezulton se i ka patur mundësitë financiare për krijimin e kësaj depozite në shumën 11.000 euro.

Komisioni ka kryer një hetim të thelluar në lidhje me aftësinë paguese të z. E. N., për dhënien e kësaj huaje.

Nga hetimi ka rezultuar:

Shtetasi E. N., ka qenë subjekt i deklaramit të interesave private për periudhën 2005-2012.

Në deklaramin e parë në datën 29.12.2005, z. N., deklaroi para *cash* 10.000.000 lekë me pjesë zotëruese 25% të deklaruara të krijuara ndër vite, dhe detyrime financiare ndaj personave juridike dhe fizike 0.

Për vitet në vazhdim deklarohen para *cash* (pa specifikuar shtesa nga viti i kaluar apo gjendje në banesë në fund të periudhës).

Nga hetimi ka rezultuar se shtetasi E. N., ka patur aftësi financiare për dhënien e kësaj huaje.

Komisioni ka konstatuar se kjo hua nuk është deklaruar nga subjekti si burim për krijimin e kësaj pasurie. Për këtë subjektin iu kalua barra e provës.

Subjekti ka sqaruar se burim krijimi nuk është huaja e marrë nga z. E. N., por pagat dhe depozita bankare, e cila maturohej disa muaj më vonë sesa afati për të shlyer këstin e fundit ndaj firmës “****”. Pra, arsyeja e marrjes së huas justifikohet nga pamundësia për të prekur depozitën para afatit të maturimit, sipas kushteve të bankës, e cila është realisht në vetvete burim financiar i shlyerjes së këstit të dytë, e gjeneruar nga të ardhurat nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortes.

Marrja e huas dhe shlyerja e saj me anë të mbylljes së depozitës brenda të njëjtit vit kalendarik është deklaruar në deklaramin periodik, ndërsa në deklaratën “Vetting” janë kërkuar detyrimet ndaj të tretëve, çka në rastin e tij e konsideron se nuk ka patur të tilla. Gjithashtu subjekti

pretendon se ka gjykuar të arsyeshme se duhet të shprehet për burimin e mirëfilltë të të ardhurave për shlyerjen e kështit të banesës.

Në lidhje me mosdeklarimin e huas si burim në deklaratën “Vetting” për pagesën e kështit të dytë, subjekti i rivlerësimit ka qenë bindës në shpjegimet e tij, duke argumentuar se burimi real kanë qenë të ardhurat e tij nga depozita në “Credins Bank”. Rezulton se subjekti i rivlerësimit ka marrë një hua të cilën e ka shlyer brenda të njëjtit vit kalendarik, menjëherë pas maturimit të depozitës së tij në “Credins Bank”. Pra, që në origjinën e blerjes së këtij apartamenti burimi i të ardhurave ka qenë depozita në “Credins Bank”, e cila është maturuar 7-muaj pas pagesës së kështit të dytë. Kjo hua bazuar në ligjin nr. 9367 nuk ka qenë e detyruar për t’u deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike pasi është shlyer brenda vitit me të ardhurat e subjektit të rivlerësimit. Në deklaratën periodike të vitit 2013 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për blerjen e këtij apartamenti depozitën në “Credins Bank”, duke deklaruar se borxhi është marrë për efekt të bankës, pasi afati për tërheqjen e depozitës ishte më datë 10.12.2014. Pra subjekti i rivlerësimit, që në origjinën e kësaj pasurie ka deklaruar si burim depozitën në bankën Credins.

- Në përfundim të hetimit për këtë pasuri, rezulton se subjekti ka patur mungesë burimesh financiare për pagimin e kështit të parë në shumën 826.717 lekë.

3. Autoveturë “Mercedes - Benz” e vitit 2003, model E220 CDI, me targë *, blerë më 01.04.2016, me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., për 5000 euro.**

Burimi i deklaruar i krijimit: Shitja e automjetit tip “Mercedes – Benz”, tip C200 CDI, me targa ***, me kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.03.2016, me vlerë 5000 euro.

Subjekti vë në dispozicion:

- Kontratë shitblerjeje automjeti, nr. *** rep, nr. *** kol., datë 01.04.2016 me shitës M. Sh., e blerës Elvin Gokaj, me vlerë 5000 euro;
- Leje qarkullimi nr. *** për automjetin me targa ***, në emër të Elvin Gokaj;
- Certifikata e pronësisë së mjetit rrugor datë 04.04.2016 për automjetin me targa *** në emër të Elvin Gokaj;
- Raporti i kontrollit teknik të mjetit në emër të Elvin Gokaj;
- Certifikatë e kontrollit teknik të mjetit rrugor, datë 05.04.2017 në emër të Elvin Gokaj;
- Policë për sigurimin e automjetit nga INSIG, datë 04.04.2016 në emër të Elvin Gokaj;
- Taksë vjetore e mjeteve me mandat nr. ***, datë 04.04.2016 në emër të Elvin Gokaj;
- Faturë tatimore nr. ***, nr. ***, nr. ***, datë 26.01.2015 për automjetin me targa ***;
- Kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.03.2016 me shitës Elvin Gokaj e blerës V. L., me vlerë 5000 euro;
- Urdhër çlirimi në emër të Elvin Gokaj;
- Formulari i zhdoganimit në Portin Detar Durrës, në emër të Elvin Gokaj, datë 22.01.2015;
- Kontratë shitjeje automjeti, datë 24.01.2015, në gjuhën italiane, në emër të Elvin Gokaj, si edhe përkthimi në gjuhën shqipe.

Hetimi i kryer nga Komisioni

- Shkresë, nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor;
Kthim përgjigjeje DPSHTR-ja, nr. *** prot., datë 02.02.2018.
Kthim përgjigjeje DPSHTRR-ja, nr. *** datë 20.02.2018.
- Shkresë, nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar Drejtorisë së Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Shkodër;
Kthim përgjigjeje Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Shkodër nr. ***, datë 07.02.2018.

Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, më datë 01.04.2016, me kontratën nr. *** rep., ka blerë makinën me targa ***, me çmimin 5.000 Euro, duke deklaruar si burim të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Mercedes – Benz” 220, me targa ***, sipas kontratës nr. *** rep., datë 26.03.2016. Pronësia e automjetit konfirmohet dhe nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Shkodër.

Komisioni administroi nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Shkodër dosjen e automjetit me targa *** nga ku konfirmohet deklarimi i subjektit. Nga analiza financiare rezulton se subjekti i ka patur mundësitë financiare.

Komisioni vlerëson se subjekti ka qenë i saktë në deklarimin e tij. Të dhënat e referuara prej tij, konfirmohen edhe nga dokumentacioni shkresor i institucioneve përkatëse.

- Nga hetimi administrativ nuk rezultojnë të dhëna të paqarta apo dyshime në lidhje me këtë pasuri.

4. Llogari në “Bankën Credins” në shumën 4.100.000 lekë.

Burimi i deklaruar i krijimit: Kursime nga paga si prokuror dhe paga e bashkëshortes ndër vite.

Subjekti vë në dispozicion:

- Nxjerrje llogarie bankare nga “Bankën Credins” me gjendje më datë 12.10.2016 në shumën 4.100.000 lekë;
- Librezë depozite e klientit Elvin Gokaj me nr. *** dhe nr. llogarie *** e çelur më datë 10.02.2014.

Hetimi i kryer nga Komisioni

- Shkresë nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë.

Me shkresën nr. *** prot., datë 21.03.2018, “Credins Bank” informon Komisionin për të gjitha lëvizjet e llogarisë në lekë të subjektit.

Arsyetimi ligjor

Referuar të dhënave nga “Credins Bank” rezulton se në datë 08.02.2011, është krijuar depozita bankare në vlerë totale **1,001,000** lekë (31.12.2011), kjo depozitë me afat (nr. ***) është krijuar nga një transfertë në datë 08.02.2011 në vlerë 748.000 lekë nga llogaria rrjedhëse e pagës në lekë dhe derdhje *cash* në datë 08.02.2011, në vlerë 253.000 lekë. Nga analiza

financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit ka patur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kësaj depozite.

Llogaria depozitë “Plus” në emër të subjektit në “Credins Bank” nr. *** është krijuar në datë 05.11.2012 nga transferta e brendshme në vlerë 500.000 lekë, nga llogaria rrjedhëse e pagës në “Credins”. Nga analiza financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit ka patur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar këtë depozitë.

Në datë 10.02.2014 subjekti i rivlerësimit ka hapur llogarinë nr. *** në lekë, e cila është krijuar nga vlerat monetare të ndodhura në dy llogaritë e trajtuara më lart. Ecuria e kësaj llogarie deri në datë 31.12.2016 paraqitet si më poshtë:

Llogaria depozitë “Plus” nr. *** në ALL në emër të Elvin Gokajt

Datë	Përshkrimi i veprimit	shtesa/pakësime	Interesa	Shuma në lekë
10.2.2014	Transfertë hyrëse	1588988		1588988
10.2.2014	Transfertë hyrëse	2110012		2110012
10.2.2014	Transfertë hyrëse	1000		1000
31.12.2014				3700000
10.2.2015	Interes neto		113220	113220
11.2.2015	Transfertë hyrëse	186780		186780
31.12.2015				4000000
10.2.2016	Interes neto		84964	84964
12.2.2016	Transfertë hyrëse	15036		15036
31.12.2016				4100000

Në përfundim rezulton se:

- Subjekti i rivlerësimit ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë.

Pasuria e bashkëshortes së subjektit, Rr. G.

1. **Depozitë me afat pranë Bankës Credins** me numër llogarie *** në vlerën 10.000 euro
Burimi i deklaruar i krijimit: Kursime nga paga ndër vite, bashkimi me depozitën 4 mijë euro nr. *** datë 15.12.2015, shitje automjeti i deklaruar me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.05.2015 në vlerën 2 mijë euro.

Subjekti vë në dispozicion:

- Librezë depozite nr. *** , çelur në datë 30.05.2013, pranë “Bankës Credins” në emër të Rr. G., në shumën 6.000 euro dhe shtuar me shumën 4.000 euro datë 31.05.2016. Gjendje në datë 31.05.2016, në vlerën totale 10.000 euro;
- Mandat depozitimi të shumës 4.000 euro, “Credins Bank”, datë 15.12.2015;
- Librezë depozite nr. *** , çelur më datë 29.05.2013, pranë “Credins Bank”, në emër të Rr. G.;
- Kontratë shitje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.05.2015, vlerë 2.000 euro. Palë shitëse Rr. G., dhe palë blerëse A. Ç.

Hetimi i kryer nga Komisioni

- Shkresë nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë.
Me shkresën nr. *** prot., datë 21.03.2018, “Credins Bank” informon Komisionin për të gjitha lëvizjet e llogarisë në lekë të subjektit.
- Shkresë nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.
Me shkresën nr. ***, datë 20.02.2018, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor i dërgon Komisionit kopje të dosjeve të automjeteve me targa ***.

Arsyetimi ligjor

1. Referuar të dhënave nga “Credins Bank” rezulton që llogaria nr. *** në euro në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit është hapur më datë 29.05.2012, duke derdhur *cash* në depozitë shumën 5 000 euro. Kjo shumë është me burim kursimet nga pagat, siç vërtetohet edhe nga lëvizjet bankare. Në datë 29.05.2013 nga kjo llogari është debituar shuma 5 000 euro me përshkrim “kalim për mbyllje llogarie depozitë”. Kjo shumë rezulton e transferuar në llogarinë dyemërore nr. *** në euro në emër të S. G., ose R. G.
Për sa më sipër rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” ka deklaruar në mënyrë të pasaktë numrin e depozitës në “Credins Bank”, pasi depozita me nr. *** rezulton e mbyllur që më datë 29.05.2013.
2. Në datën 30.05.2013, llogaria nr. *** në euro në emër të bashkëshortes së subjektit në “Credins”, është kredituar me shumën 6000 euro, e cila e ka burimin nga urdhërhirimi i brendshëm me urdhërues S. G., ose G., Rr. me përshkrim “*kalim në depozitë 12 mujore nga llogaria nr. ****”.

Më datë 15.12.2015, nëpërmjet një derdhjeje *cash* në shumën 4.000 euro, është hapur llogaria nr. *** në emër të znj. Rr. G. Si burim për çeljen e llogarisë nr. *** subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave të vitit 2015 ka deklaruar shitje automjeti si dhe tërheqje nga llogaria në “Raiffeisen Bank”, honorare nga Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se znj. Rr. G., ka shitur me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.05.2015 automjetin tip “Ford Fiesta” me vlerë 2 mijë euro.

Në datë 31.05.2016 në llogarinë nr. ***, në euro, është transferuar shuma prej 4004.65 euro me përshkrimin “*kalim në dep. 12 M nga llogaria nr. *** e znj. R. G.*”.
Gjendja në datë 31.12.2016 e llogarisë nr. *** është 10.001.48 euro.

Komisioni konstaton se ndryshe nga sa ka deklaruar subjekti në pëgjigje të pyetësorit, më datë 10.12.2018, bashkëshortja e tij ka kryer transferta bankare nga llogaria e saj personale në llogarinë e përbashkët me nënën e subjektit dhe anasjelltas, duke krijuar paqartësi në burimin e të ardhurave të deklaruara nga subjekti.

Në përfundim subjektit iu kalua barra e provës bazuar në këto rezultate të hetimit:

- a. Deklarimet e subjektit nuk përputhen me të dhënat e administruara nga hetimi në lidhje me burimin e krijimit të kësaj depozite;
- b. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar transfertat bankare të kryera nga bashkëshortja e tij tek nëna e tij dhe anasjelltas.

Pas kalimit të barrës së provës për këto rezultate të hetimit, subjekti i rivlerësimit sqaroi se:

- a. Lidhur me germën “a”, duke iu referuar edhe vetë rezultatit të hetimit nga Komisioni, gjendja e depozitës nr. *** në 31.12.2016 është 10.001,48 euro. Burimi i kësaj shume është: depozita nr. *** (titullare Rr. G.), hapur më 29.05.2012, me vlerë 5.000 euro, e cila në momentin e maturimit cit. 29.05.2013 kapitali së bashku me interesat kalojnë automatikisht në llogari rrjedhëse ndihmëse nr. ***, sipas pikës 2.2 seksioni V për maturimin e depozitës, në kontratën me bankën, bëhet një derdhje *cash* prej 538 euro si dhe kalime automatikisht të interesave nga llogari të tjera dyemërore dhe arrin shumën 6.000 euro.

Kjo shumë është xhiruar në depozitë me nr. ***, datë 30.05.2013, me datë maturimi 30.05.2015. Kësaj depozite i është bashkuar shuma 4.004,65 euro nga depozita nr. ***, çelur në 15.12.2015 me afat 3- mujor, me qëllim maturimin para datës 30.05.2016, datë në të cilën maturohej depozita nr. ***.

- b. Lidhur me lëvizjet bankare të bashkëshortes, në lidhje me depozitat dyemërore, ku titullare e kapitalit është nëna ime, ju sqaroj sërish, ashtu siç e kam theksuar tek përgjigjet e pyetësorit nr. 3, datë 11.12.2018, pyetja 2 e tij, se bashkëshortja ime ka qenë person i besuar nga prindërit e mi dhe i njohur nga banka në lidhje me veprimet bankare; por në çdo rast kapitali në llogaritë dyemërore ku emër i parë është S. G., është pasuri monetare e prindërve krijuar nga kursimet e veta.

Gjithashtu, në konsultim me punonjësit e bankës, pasi kanë konsideruar lëvizjet, sqaroj se lëvizjet bankare të bashkëshortes sime, sipas logjikës ekonomike bankare nuk konsiderohen transferta të mirëfillta bankare, por urdhërhirime të brendshme, të cilat kryhen gjithmonë me miratim paraprak të urdhërhiruesit sipas rregullave të bankës përkatëse. Depozitat në emër të vetëm të bashkëshortes sime, si dhe depozitat dyemërore ku Rr. G., është person i besuar nga titullari i kapitalit, në momentin e çeljes së tyre janë të lidhura automatikisht me numër llogarie rrjedhëse ndihmëse.

Kjo llogari ndihmëse krijohet sipas kushteve të bankës “Credins”, dhe në kontratat me bankën kryen këtë funksion, citoj nga kontrata seksionin V: Maturimi, pikën 2,2: “*Vlera e interesit dhe kapitali kalojnë në llogari rrjedhëse dhe në rast se depozituesi nuk ka llogari rrjedhëse do i hapet automatikisht një e tillë*”. Pra, është fare e qartë se llogaria rrjedhëse ndihmëse shërben për të mbajtur kapitalin bashkë me interesat, çka ndodh automatikisht nga Banka në ditën e maturimit të depozitës, dhe urdhërhiruesi mund të paraqitet përtej datës së caktuar të maturimit të kapitalit dhe të kryejë lehtësisht veprime sipas nevojës me shumat që i nevojiten.

Subjekti i rivlerësimit së bashku me shpjegimet ka depozituar dokumentet e mëposhtëm:

- Kërkesë për çelje llogarie individuale datë 29.05.2012;
- Kontratë depozite me afat datë 29.05.2012 në “Credins Bank”. Në pikën 2.2 të kësaj kontratë është vendosur me shkrim dore numri i llogarisë ***;
- Nxjerrje e llogarisë nr. *** për periudhën 2012-2013 e datës 27.05.2019;
- Kontratë depozite me afat datë 30.05.2013;
- Librezë depozite për llogarinë nr. *** dhe llogarinë nr. ***;
- Mandatarkëtimi në “Credins Bank”, datë 15.12.2015;
- Urdhërhirim i brendshëm i “Credins Bank”, datë 31.05.2016.

Nga analizimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit, si dhe shpjegimeve të tij, rezulton se llogaria dyemërore ka qenë llogari ndihmëse e llogarisë depozitë të hapur

nga znj. Rr. G., duke konfirmuar në këtë mënyrë pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk ka patur asnjë kalim ndërmjet llogarive dyemërore dhe llogarive së bashkëshortes së tij dhe se burimi i krijimit të depozitës së znj. Rr. G., kanë qenë të ardhurat e krijuara nga ana e tij dhe bashkëshortes së tij.

- Komisioni vlerëson se subjekti ka qenë i saktë në deklarinimin e tij. Të dhënat e referuara prej tij konfirmohen edhe nga dokumentacioni shkresor i institucioneve përkatëse. Nga hetimi administrativ nuk rezultojnë të dhëna të paqarta apo dyshime në lidhje me këtë pasuri.

2. **Depozitë me afat pranë bankës “Credins”** me numër llogarie *** në vlerën 10 000 euro, çelur më datë 26.08.2016.

Burimi i deklaruar i krijimit: kursime nga paga ndër vite, mbyllja më 26.07.2016 e depozitës në lekë, e deklaruar me numër ***, mësimdhënie në Hungari në Universitetin “****”.

Subjekti vë në dispozicion:

- Librezë depozite nr. ***, çelur në datë 26.08.2016, në vlerën 10.005 euro;
- Kontratë depozite me afat nr. ***, në “Credins Bank”, nënshkruar në datë 26.08.2016, nga Rr. G., për shumën e depozituar në vlerën 10.005 euro, afat 12 muaj deri në datë 26.08.2017;
- Mandat bankar depozitim në llogari pranë “Credins Bank”, të vlerës 10.005 euro në datë 20.06.2016;
- Mandat bankar tërheqje *cash/mbyllje* depozite në “Credins Bank”, të vlerës 1.000.100 lekë në datë 26.07.2016, nga Rr. G., dhe tërheqje në llogari bankare të shumës 5.000 euro, konvertuar në shumën 702.000 lekë më datë 26.08.2016;
- Mandat bankar tërheqje *cash*, në “Credins Bank”, nga Rr. G., të vlerës 137.000 lekë, në datë 26.08.2016;
- Librezë depozite nr. ***, çelur më datë 06.06.2015, në vlerën 1.000.100 lekë dhe tërhequr në datë 26.07.2016.

Hetimi i kryer nga Komisioni

- Shkresë, nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë. Me shkresën nr. *** prot., datë 21.03.2018, “Credins Bank” na informon për të gjitha lëvizjet e llogarisë në lekë të subjektit.

Arsyetimi ligjor

Referuar të dhënave nga “Credins Bank” rezulton që llogaria nr. *** në euro në emër të bashkëshortes së subjektit është krijuar në datë 26.08.2016 me derdhje *cash* në vlerë **10.005 euro** me përshkrimin “*derdhje në depozitë, të ardhura nga kursimet familjare*”.

Si burim në deklaratën “Vetting” është deklaruar mbyllje në datë 26.07.2016 të depozitës në lekë, e deklaruar me nr. ***.

Depozita me nr. *** në “Credins Bank” në emër të bashkëshortes së subjektit është krijuar në datë 06.06.2015, me një urdhërshirim të brendshëm në vlerë 1,000,100 lekë me urdhërues S. G., ose G. Rr. (llogari e përbashkët) me përshkrim kalim në depozitë 1 emërore. Kjo shumë e ka burimin nga llogaria nr. *** në emër të S. G., ose Rr. G. Në datë 04.06.2015 në këtë llogari

ka kaluar me urdhërues R. G. shuma 1,000,000 lekë nga llogaria nr. ***. Kjo llogari është kredituar në datë 13.01.2015 me derdhje *cash* në vlerë 444,000 lekë, e cila është tërhequr nga llogaria në lekë në “BKT” në datë 13.01.2015 si dhe një urdhërshirim i brendshëm me urdhërues R. G. në shumën 557,500 lekë.

Kjo depozitë ka zgjatur deri në datë 26.07.2016, dhe është mbyllur me tërheqje *cash* në vlerë 1,000,100 lekë. Në lidhje me këto llogari subjekti i rivlerësimit si burim për këtë llogari në deklaratën e interesave private të vitit 2015 ka deklaruar: teprica nga paga 2014 (UAMD) në “Credins” dhe derdhje *cash* në “Credins Bank” datë 13.01.2015 (shumë e tërhequr nga “BKT”, honorare të mbetura nga 2014).

Në përfundim rezulton se:

- ➔ Subjekti i rivlerësimit ka qenë i saktë në deklarinimin e tij.

3. Llogari bankare të përbashkëta

Nga hetimi administrativ ka rezultuar që për periudhën 2010-2016 bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka patur llogari të përbashkëta në “Credins Bank” me znj. S. G. (nëna e subjektit të rivlerësimit) dhe znj. L. P. (nëna e saj).

Këto llogari nuk rezultojnë të deklaruara në deklaratat periodike të interesave private të subjektit të rivlerësimit. Ndërkohë tek seksioni të dhëna konfidenciale të deklaratës së interesave të vitit 2015 të subjektit të rivlerësimit, bashkëshortja e tij deklaroi se lidhur me të gjitha depozitat që figurojnë edhe në emrin e saj si person i autorizuar në bankën “Credins” nga titullari i kapitalit S. G. (vjehera), nuk ka asnjë pjesë të kapitalit apo interesi, por në rastin më të parë të ardhjes nga Italia personi do të bëjë shkëputjen e emrit.

Referuar të dhënave nga “Credins Bank” me shkresën nr. ***prot., datë 21.03.2018, këto llogari dhe gjëndjet e tyre në fund të çdo viti pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Produkti bankar	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Depozitë Eur 12 muj 2EM S. G. dhe R. G.	5400	5618					
Depozitë Lek 12 muj 2EM L. P. dhe R. G.			1000004				
Depozitë Eur 12 muj 2EM S. G. dhe R. G.			10005				
Depozitë Eur 6 muj 2EM S.G. dhe R. G.			10005				
Depozitë Eur 12 muj 2EM S. G. dhe R. G.				10232	15599	15599	
Depozitë Eur 12 muj 2EM S. G. dhe R. G.				10005	10004	15160	
Depozitë Lek 6 muj 2EM S. G. dhe R. G.				1010010			

Depozitë Eur 6 muj 2EM S. G. dhe R. G.	5000	
Depozitë Lek 12 muj 2EM S. G. dhe R. G.	1010010	
Depozitë Lek 12 muj 2EM S.G. dhe R. G.		1001900

Në lidhje me këtë konstatim iu kërkua informacion subjektit të rivlerësimit në lidhje me përkatësinë e vlerave monetare në këto llogari, si dhe burimin e të ardhurave për krijimin e tyre, subjekti, më datë 11.12.2018 sqaron se:

“...çdo llogari bankare e çdo lloj banke që operon në Shqipëri, ku titullar i kontratës me bankën është nëna ime S. G., janë kursimet e prindërve të mi me të ardhurat ndër vite që kanë përfituar në Itali...bashkëshortja ime ...nuk ka patur asnjë rast të derdhjes apo tërheqjes së kapitalit pa praninë e nënës sime...”

Lidhur me burimin e të ardhurave për krijimin e këtyre vlerave monetare prindërit e subjektit kanë deklaruar se :

“..Jetojmë në Itali që prej vitit 1999 përmes bashkimit familjar me djalin tonë...unë B. G., kam punuar gjatë kësaj periudhe në ndërmarrje të ndryshme dhe kam patur të ardhura të mjaftueshme për jetesë modeste me bashkëshorten. Të ardhurat e mia janë edhe përfitime nga Instituti i Sigurimit Shëndetësor, pasi kam pësuar aksidente, për të cilat jam rimbursuar nga shteti Italian...”

Për të mbështetur deklarinimin e tyre subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacion provues në lidhje me burimin e të ardhurave të babait të tij, i cili përbëhet nga ekstrakt i datës 31 janar 2007 të (Banka Popolare di Intra) në të cilën llogaria në emër të B. G., ka një saldo 30.168.34 euro, (në datë 24.01.2007 ka një kreditim në vlerë 21.130 euro me përshkrim derdhje e çekut të kryer nga jashtë), ekstrakt i INPS (Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore i përkthyer, noterizuar nga A.S., në të cilin paraqiten të ardhurat për periudhën 01.04. 2001-15.10.2017), CUD ndër vite të z.B. G.

Nga ekstrakti i INPS rezulton se të ardhurat e babait të subjektit të rivlerësimit kanë qenë si më poshtë:

Periudha	Vlera në euro
01/04/2001-31/12/2010	160960,44
01/01/2011-15/10/2017	139597,00
Totali	300557,44

Për sa më sipër rezulton se subjekti i rivlerësimit ka provuar me dokumentacion provues të ardhurat e babait të tij.

Bazuar në mandatin e datës 06.06.2016 të “Credins Bank” rezulton se znj. S. G., ka transferuar shumën 30.000 euro (shuma totale e llogarive të përbashkëta) në llogarinë e saj personale në “Credins Bank”.

Referuar të dhënave nga “Credins Bank” rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka patur një llogari të përbashkët me nënën e saj znj. L. P.

Në lidhje me këtë llogari i është kërkuar informacion subjektit të rivlerësimit i cili sqaron se: “...Vlerat monetare në fjalë është plotësisht e kursimeve dhe të ardhura nga emigracioni i djemve të saj...”.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion provues për të ardhurat, ashtu si ka bërë në rastin e llogarive të prindërve të tij.

Ndërkohë në datë 14.08.2013 nga kjo llogari është transferuar shuma në vlerë 1,010,010.72 lekë, në llogarinë nr. *** në emër të S. G., ose Rr. G. Llogaria në emër të S. G., ose Rr. G., në datën 06.06.2016 mbyllet me një tërheqje *cash* të shumës 1,001,900 lekë, pa u identifikuar personi që kryen këtë tërheqje.

Në përfundim subjektit iu kalua barra e provës bazuar në këto rezultate të hetimit:

- a. Subjekti nuk provon me dokumentacion ligjor burimin e të ardhurave të ligjshme të nënës së bashkëshortes së tij, znj. L. P.
- b. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në lidhje me llogaritë dyemërore, pasi, siç rezulton, ka transferua bankare ndërmjet llogarive të prindërve të tij dhe nënës së bashkëshortes së tij.
- c. Është e paqartë se cila ka qenë arsyeja e transferimit të shumës 1,010,010.72 lekë nga llogaria e nënës së bashkëshortes së tij tek llogaria e prindërve të tij, si dhe kush e ka tërhequr këtë shumë në datën 06.6.2016.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka sqaruar:

Në lidhje me germën “a”, për të provuar të ardhurat e ligjshme të znj. L. P., ka paraqitur deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., të datës 08.12.2018, dokumentacionin bankar për llogarinë përkatëse, dokumente provues të marra nga puna në emigrim e djemve të saj, D. P., në Itali dhe F. P., në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe vërtetimet e pensioneve, në përputhje me citimet e saj në deklaratën noteriale të lartpërmendur, të gjitha bashkëlidhur.

Sipas deklaratës së datës 29.05.2019 të z. D. P., (datëlindja 02.07.1971), rezulton se: “...kam emigruar në Itali rreth vitit 1994, ku kam qëndruar dhe punuar deri në vitin 2009... gjatë periudhës si emigrant në Itali kam ndihmuar ekonomikisht prindërit e mi N. dhe L. P., të cilët herë pas here e kanë parë të arsyeshme që një pjesë të kursimeve ta depozitojnë në banka të ndryshme, sipas interesave bankare më të volitshme...”

Bashkëlidhur deklaratës z. D. P., ka paraqitur një pasqyrë me të ardhurat nga emigracioni për periudhën 1996-2009, konkretisht:

Periudha	Vlera në Lireta	Vlera në Euro
1996	9529000	
1997	11485413	
1998	5613000	
1999	1145000	
2000	0	
2001	68000	
2002		7964
2003		8291
2004		10629

2005		17250
2006		12517
2007		10547
2008		22978
2009		6145
Totali	27840413	96321

Kursit mesatar i vitit 2001, (1000 ITL=63.01 ALL)

-Të ardhurat e vëllait të bashkëshortes F. P., dhe familjes së tij, në USA, referuar formularëve (**US Individual Income Tax Return**), për periudhën 2006-2013, rezultojnë në vlerë 200.303 USD, konkretisht:

Periudha	Total të ardhura në USD (gross income)
2006	38242
2007	37231
2008	25014
2009	14967
2010	18641
2011	25491
2012	20567
2013	20150
Total	200303

Nga analiza financiare rezulton se znj. L. P., kishte të ardhura të mjaftueshme për të hapur llogarinë bankare.

Në lidhje me germën “b” subjekti ka sqaruar se llogaritë dyemërore të Rr. G., me S. G., ose L. P., nuk i ka konsideruar objekt i deklarimit të pasurisë, pasi kapitali i depozituar është në të gjitha rastet ose i S. G., (ku person i besuar është Rr. G.,) ose i L. P., (ku person i besuar është Rr. G.), siç edhe rezulton nga deklaratat noteriale përkatëse të titullareve të kapitaleve respektive, të paraqitura në përgjigje të pyetësorit nr. 3, datë 11.12.2018. Megjithatë, në konsultim me punonjësit e bankës thekson se nuk ka asnjë rast për transferta bankare të tilla nga llogaritë e depozitave dyemërore S. G., (Rr. G.) tek llogaria e depozitës dyemërore L. P. (Rr. G.) dhe anasjelltas. Për më tepër, depozita e L. P., ka kaluar automatikisht për mbyllje në afatin e maturimit cit. 29.05.2013, dhe ajo e ka tërhequr shumën përkatëse personalisht. Ndërsa S. G., ka kaluar në llogarinë e saj personale kapitalin e vet duke u shkëputur nga llogaritë dyemërore me Rr. G., në 06.06.2016.”

Lidhur me germën “c” subjekti ka sqaruar se: “Në datën 14.08.2013 është çelur depozita nr. *** në emër të S. G., dhe Rr. G., (person i besuar), e cila mbyllet me një tërheqje *cash* të shumës 1,001,900 lekë në datën 06.06.2016. Sipas relacionit nuk është i identifikuar personi që kryen këtë tërheqje, dhe për këtë arsye ka vënë në dispozicion mandatin e “Bankës Credins” lidhur me këtë tërheqje që është kryer nga vetë S. G., e cila ia ka dhënë borxh këtë shumë me deklaratë noteriale nr. *** rep., *** kol., datë 10.06.2016 personit V. G. Burimi

i kësaj depozite është kthimi i borxhit që V. G., i kishte marrë më herët prindërve të tij, që në momentin e kthimit, me miratim paraprak i sjell tek bashkëshortja e tij, Rr. G., duke qenë se ishte person i autorizuar për të kryer veprimet me bankat. Shuma 1.010.010,72 lekë është derdhur nga Rr. G., në llogarinë rrjedhëse dyemërore për të shmangur mbajtjen e parave në banesë, me qëllim që S. G., me ardhjen më të parë në Shqipëri, të ketë mundësi të veprojë si ta gjejë të arsyeshme me këtë shumë, veprim i kryer nga vetë S. G., si titullare e depozitës me dt 14.08.2013. Lidhur me këtë hua ai ka paraqitur si dokumentacion provues një deklaratë noteriale datë 06.06.2019 që V. G., e lëshon para noterit për të sqaruar këtë moment.

Lidhur me lëvizjet me urdhërhirime të brendshme të kryera në llogaritë rrjedhëse dyemërore nga Rr. G., sqarohet se këto veprime janë kryer meqenëse Rr. G., ka patur akses si person i besuar për të kryer veprime bankare edhe nga S. G., edhe nga L. P., dhe lëvizjet në llogaritë rrjedhëse dyemërore janë bërë gjithmonë në konsultim me punonjësit e bankës për të lehtësuar procedurat bankare, gjithmonë në mirëbesim dhe porosi paraprake nga vetë titullarët e kapitaleve respektive. Gjithashtu, vlen të theksohet se në asnjë rast titullarët e depozitave përkatëse nuk kanë ngritur asnjë pretendim lidhur me veprimet bankare të kryera nga Rr. G. (bashkëlidhur dokumente mbështetëse).”

Në mbështetje të këtyre shpjegimeve, subjekti ka bashkëlidhur:

- Deklaratë e shtetasit D. P., e datës 29.05.2019, i cili deklaron se ka emigruar në Itali në vitin 1994 dhe ka punuar deri në vitin 2009. Të ardhurat kanë qenë të mjaftueshme për jetesë dhe ka ndihmuar here pas here familjen. Prindërit e tij të ardhurat e dërguara prej tij i kanë depozituar nëpër banka të ndryshme sipas interesave bankare më të volitshme për to;
- Tabelë përmbledhëse të ardhurave nga emigracioni;
- Fotokopje të faqes së parë të pasaportës së z. D. P.;
- Certifikatë personale nxjerrë nga portali “e-albania”;
- Dokumentacion në lidhje me të ardhurat e z. R. (D.) P., për periudhën 1996-2009 në gjuhën italiane i noterizuar nga një noter publik shqiptar;
- Dokumentacion fotokopje në gjuhën angleze në lidhje me të ardhurat e z. F. P., për periudhën 2006-2013;
- Vërtetim i Institutit të Sigurimeve Shoqërore Drejtoria Rajonale Shkodër nr. *** prot., datë 29.05.2019 nga ku rezulton se znj. L. P., trajtohet me pension në masën 15,903 lekë;
- Vërtetim i Institutit të Sigurimeve Shoqërore Drejtoria Rajonale Shkodër nr. *** prot., datë 29.05.2019 nga ku rezulton se z. N. P., trajtohet me pension në masën 20,122 lekë;
- Deklaratë noteriale, kopje nr. ***, datë 08.12.2018 e znj. L. P., dhe R. G., në këtë deklaratë nga znj. L. P., deklarohet se:

“Unë L. P., jam e martuar dhe kam tre fëmijë: D. P., F. P., dhe R. G. Djemtë kanë emigruar jashtë vendit në Itali dhe SHBA. Ndër vite më kanë sjellë vazhdimisht shuma monetare modeste nga puna e kryer në emigrim dhe unë i kam kursyer së bashku me bashkëshortin, pasi kemi patur të ardhura edhe nga pensionet tona. Për efekt sigurie dhe normash interesi këto shuma i kemi depozituar fillimisht në “Raiffeisen Bank” e ndër vite i kemi kaluar tek “Credins”... Gjatë veprimeve bankare më ka shoqëruar bija ime, R. G., ku sipas rekomandimeve të punonjësve të bankës “Credins” mund të ishte personi im i besuar për të kryer veprimet në mungesën apo pamundësinë time. Deklaroj...asnjë pjesë e kapitalit të

depozituar nga ana ime...nuk ka qenë dhe nuk është e ardhura apo aset i vajzës time... por vetëm burimet kryesisht nga djemtë e mi emigrantë.”

- Nxjerrje llogarie nr. ***;
- Mandat tërheqje *cash* datë 22.06.2013 nga L. P., në llogarinë nr. ***;
- Deklaratë noteriale nr. *** datë 26.04.2019 e S. dhe B. G., të cilët deklarojnë se:
“...Çdo kursim gjatë viteve në Itali kemi menduar së bashku me bashkëshorten ta depozitojmë në Shqipëri në periudha të ndryshme. Për shkak të moshës dhe sipas rastit të pamundësisë për të qenë gjithmonë prezent për procedura bankare në kohën e maturimit të depozitave, kemi vepruar sipas sugjerimit të punonjësve të bankave përkatëse në lidhje me personin e autorizuar për të kryer çdo lloj veprimi...Për sa më sipër bashkëshortja ime S. G., ka vepruar në mirëkuptim të plotë familjar lidhur me kursimet tona dhe si person të autorizuar kemi rënë dakord të jetë R. G...Që nga viti 2016 e në vijim S. G., është titullare e vetme depozitave.

Theksojmë se çdo llogari bankare në çdo lloj banke që operon në Shqipëri, ku titullar i kontratës me bankën është S. G., është rezultat i kursimeve tona nga të ardhurat në Itali dhe se asnjë pjesë përqindje apo shumë e tyre nuk është e djalit tonë, Elvin Gokaj apo e bashkëshortes së tij R. G.”

- Kontratë depozite datë 14.08.2013;
- Mandat 06.06.2016 tërheqje *cash* shuma 1,001,900 lekë nga znj. S. G., në Bankën “Credins”.
- Deklaratë noteriale nr. ***, datë 10.06.2016 e S. G., dhe V. G., ku deklarohet:
“Znj. S. G., i ka dhënë hua shumë 10.000 euro z. V. G.”

Bashkëlidhur deklaratës është dhe mandati i datës 06.06.2016.

- Deklaratë noteriale nr. *** datë 06.06.2019 e z. V. G., i cili deklaron:
“Jam me banim në qytetin e Shkodrës, ushroj aktivitet privat në fushën “Transport udhëtarësh brenda dhe jashtë vendit” me NIPT ***. B. G., është xhaxhai im...Para se të martohesha në vitin 2009 i kam kërkuar borxh shumë 500,000 lekë, të cilat m’i dha kur erdhi nga Italia. Në total i kam pasur 1,000,000 lekë. Nga muaji qershor këtë vlerë e kam patur gjendje dhe kam komunikuar me xhaxhain dhe nusen e tij dhe me kanë thënë t’ia jepja nuses së djalit të tyre, znj. R. G...”

Nga analizimi i dokumentacionit të administruar dhe shpjegimeve të subjektit rezulton se ai ka qenë i saktë në deklaratën “Vetting”, pasi llogaritë dy emërore janë mbyllur gjatë vitit 2016, sikundër është deklaruar në deklaratën e interesave private të vitit 2015, rrjedhimisht subjekti i rivlerësimit nuk ka patur detyrimin ligjor për të deklaruar këtë llogari. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se mbajtësit e llogarive, prindërit e tij si dhe nëna e bashkëshortes së tij, kanë vërtetuar me dokumentacion provues aftësinë financiare të tyre për të hapur këto depozita dhe, rrjedhimisht nuk lindin dyshime që këto llogari të kenë si burim të ardhura të krijuara në mënyrë të paligjshme nga subjekti i rivlerësimit.

Konkluzioni përfundimtar për pasurinë

Në përfundim të hetimit administrativ, pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar nga hetimi, provat dhe shpjegimet e subjektit, si dhe e dëgjoi atë në seancë, Komisioni konstaton se subjekti ka qenë i saktë në deklarimin e tij, por ka patur pamjaftueshmëri të mjeteve financiare në shumë 826.717 lekë, për pagesën e kështit të parë për pasurinë e ndodhur në Durrës.

Duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e kësaj pamjaftueshmërie, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, Komisioni vlerëson se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të veta, si detyrimi kryesor kushtetues i tij. Mungesa e të ardhurave për pagesën e këstit të parë nuk mund të shërbejë si shkak për masë disiplinore, duke qenë se nuk përmbushen kriteret e parashikuara në pikën 1 dhe 3 të nenit 61.

Komisioni konkludon se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Procesi i rivlerësimit, në referim të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Elvin Gokaj, ka vijuar mbështetur në administrimin e dokument/raportit të strukturës përgjegjëse për kontrollin e figurës; procedurës për kontrollin e saj; vlerësimit, verifikimit dhe standarteve të kontrollit bazuar në provat, informacionet konfidenciale, si dhe informacionet e tjera të disponuara nga grupi i punës i përbërë nga: Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK), Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH) dhe Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave (SHKÇBA) pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Fillimi i procedurës për kontrollin e figurës bazuar në nenin 35 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, referon për subjektin e rivlerësimit z. Elvin Gokaj, fillimisht mbi verifikimin e standardit të plotësisë të deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit, kohës së paraqitjes së deklaratës dhe saktësisë së saj, e cila është dërguar pranë Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar.

Në referim të shkresës me nr. *** prot., datë 02.11.2017, të DSIK-së me lëndë “Dërgohet raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit z. Elvin Gokaj”, dokument i deklasifikuar me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 20.02.2018 dhe nuk përbën më “sekret shtetëror”, me nivel klasifikimi “sekret”, rezulton se formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga subjekti i rivlerësimit z. Elvin Gokaj.

Bazuar në këto informacione të këtyre institucioneve, Raporti evidenton dhe konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Elvin Gokaj.

Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

1. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se subjekti ka patuar marrëdhënie huadhënie me shtetasin E. N. Marrëdhënia shoqërore e tyre konfirmohet edhe nga subjekti.

Në lidhje me këtë shtetas, Komisioni i ka kërkuar informacion Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila me shkresën nr. *** .prot (E.A) datë 27.07.2018 ka vënë në dispozicion fashikujt e procedimit penal nr. *** të vitit 2014 **të dërguar në gjykim** ku shtetasi E. N., akuzohet për veprën penale “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i K. Penal dhe fashikujt e procedimit penal nr. *** të vitit 2015, **i pushuar në datën 18.05.2017**, ku shtetasi E. N., dyshohet se ka kryer veprën penale “Pastrim i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i K. Penal.

Në lidhje me procedimin penal nr. *** rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka dërguar për gjykim shtetasin E. N., për akuzën “Shpërdorim detyre”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin penal nr. *** (11-2018-***) datë 29.01.2018 ka vendosur të deklarojë të pafajshëm të pandehurin E. N., për veprën penale “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i K. Penal. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës.

Në lidhje me procedimi penal nr. ***² rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur pushimin e tij në bazë të nenit 328, pika 1, germa “b” të K. Pr. Penale³ duke arsyetuar:

“Në analizë të fakteve të parashtruara më lartë, ekzistojnë dyshime se shtetasi E. N., së bashku me shtetasit M. B., dhe A. Ç., kanë kryer veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” Parashikuar nga neni 248 i K. Penal, për të cilën Prokuroria Pranë Gjykatës së shkallës së Parë durrës, ka dërguar çështjen për gjykim dhe vazhdon akoma procesi gjyqësor në shkallë të parë. Mirëpo nga hetimet e gjithanshme të zhvilluara nuk është arritur të provohet se shtetasi E. N., nga aktiviteti kriminal i dyshuar (shpërdorim detyre), ka përfutur pasuri apo vlera financiare për vete apo për persona të tjerë, dhe më tej, këto pasuri dhe vlera financiare nëpërmjet veprimeve të ndryshme t’i ketë fshehur apo mbuluar origjinën e paligjshme. Së dyti : nga hetimet e kryera rezultoi se vlera e pasurisë së shtetasve E. N., dhe personave të lidhur me të, rezulton e justifikuar nga burime të ligjshme të ardhurash, çka do të thotë se mungon një ndër elementët thelbësore (ana objektive) të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 287 i K. Penal, siç është ekzistenca e pasurisë së paligjshme (të pajustificuar me burime të ligjshme)

Mbështetur sa më sipër, hetimet për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i K. Penal, duhet të pushohen sepse ekzistojnë shkaqe ligjore për një gjë të tillë, pasi nga hetimi i gjithanshëm dhe objektiv i kësaj çështjeje, rezultoi se fakti i parashtruar më sipër, nuk përbën vepër penale.”

Neni DH, paragrafi 2 i Aneksit të Kushtetutës, parashikon se: “Subjektet e rivlerësimit plotësojnë dhe i dorëzojnë Komisionit një deklaratë të detajuar për figurën e tyre, që mbulon periudhën nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklaramit sipas ligjit”.

Subjekti i rivlerësimit Elvin Gokaj ka plotësuar dhe dorëzuar “Deklaratën për kontrollin e figurës më **24.01.2017**. Në shtojcën 3, pjesa 5 “Të dhëna për sigurinë” pyetjes “C” (A keni patur kontakte të papërshtatshme në formën e një takimi, komunikimi elektronik ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës?)“Ç” A keni pasur kontakte të përshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar në ushtrimin e detyrës tuaj?”E”

² Regjistruar më datë 21.12.2015.

³ Neni 328 “Pushimi i çështjes” (Shtuar pika 1 me ligjin nr. 8460, datë 11.2.1999).

1. Në çdo fazë të procedimit, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur:
b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale;

A keni pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar?

Subjekti i rivlerësimit u është përgjigjur “Jo”.

Në bazë të nenit 3 (Përkufizime) pika 15 e ligjit nr. 84/2016 “Person i përfshirë në krimin e organizuar është çdo person që është dënuar **ose proceduar penalisht** për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 ”Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. Një ndër veprat e përfshira në këtë nen është dhe vepra penale e “pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Siç rezulton me lart, procedimi penal nr.1223/1/2015 ka qenë ende në fazën e hetimit në momentin, që subjekti i rivlerësimit ka plotësuar deklaratën e kontrollit të figurës, duke e ngarkuar me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit për mosplotësimin e saktë të deklaratës së kontrollit të figurës për sa kohë ai nuk ka deklaruar se ka patur kontakte me shtetasin E. N., i cili siç rezulton ka qenë i proceduar për një vepër penale që përfshihet në krimin e organizuar.

Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, për sa kohë nga ana e subjektit të rivlerësimit i është marrë hua shtetasit E. N., dhe nga ana e tij është pranuar marrëdhënia miqësore ndërmjet tyre, subjektit iu kalua barra e provës bazuar në këto rezultate të hetimit:

- a. Subjekti i rivlerësimit duket se nuk ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës.
- b. Subjekti i rivlerësimit duket se nuk ka deklaruar se ka patur kontakte me një person të proceduar penalisht, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë për veprën penale të “Pastrim i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i K. Penal

Pas kalimit të barrës së provës subjekti i rivlerësimit sqaroi se:

“Pas vënies në dijeni të relacionit nga KPK-ja, deklaroj se nuk kam patur dijeni në kohën kur kam plotësuar deklaratën e kontrollit të figurës, që ai ka qenë i proceduar penalisht për veprën penale të "Pastrim i produkteve të veprës penale", parashikuar nga neni 287 i K. Penal. Gjithashtu, jam interesuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe prej tyre më është kthyer përgjigje me shkresën nr. *** prot., datë 28.05.2019 se nga verifikimet e kryera në lidhje me çështjen penale nr. *** datë 21.12.2015, për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal, rezulton se për këtë procedim, shtetasi E. N., nuk është marrë as si person nën hetim dhe as si i pandehur. Në përfundim të hetimeve, më datë 18.05.2017 është vendosur pushimi i çështjes penale nr. ***, datë 21.12.2015. Procedimi penal nr. *** është rregjistruar si procedim i ndarë më datë 21.12.2015, për të cilin më pas është vendosur pushimi i çështjes më datë 18.05.2017, periudhë në të cilën unë nuk kam qenë me detyrë në Prokurorinë e Durrësit. Në mënyrë që një person të mbajë mbi vete barrën si i proceduar penalisht, minimalisht atij duhet t'i rregjistrohet emri në regjistrat përkatës si person nën hetim. Në rastet kur nuk regjistrohet emri si person nën hetim, vërtetimi mbi qenien në ndjekje apo jo të personit, lëshohet i pastër nga prokuroria, pra, se ndaj tij nuk ka çështje të regjistruar.

Shtetasi E. N., nuk më ka thënë asnjëherë që ka qenë nën hetim për këtë vepër penale. Gjithsesi, në atë periudhë unë nuk kam ushtruar funksionet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, pasi me dekretin nr. ***, datë 18.06.2014 jam emëruar në Prokurorinë e Apelit Shkodër dhe si rrjedhojë, kontaktet me shtetasin E. N., kanë qenë më të rralla, dhe për këto arsye, mes të tjerash, nuk kisha si të isha në dijeni që kishte procedim

penal për atë veprë penale. Gjithashtu, as bashkëshortja ime dhe as unë nuk kemi qenë të punësuar në ndonjë nga institucionet ku kërkohen informacione në kuadër të hetimit pasuror që në ndonjë formë të merrja dijëni lidhur me këtë procedim. Duke i mëshuar faktit se raste të tilla përbëjnë sekret hetimor, përjashtohet mundësia që nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës të kisha informacion për këtë procedim.

I vetmi informacion që kam pasur për shtetasin E. N., ka qenë periudha kur është arrestuar për veprën penale "Shpërdorim detyre", parashikuar nga neni 248 i K.Penal. Megjithëse vepra penale e "Shpërdorimit të Detyrës" nuk është objekt deklarimi sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksi, neni DH, unë gjithsesi e kam referuar në pyetësonin nr. 2 dt. 20.09.2018 dijeninë time lidhur me këtë veprë penale.

Informacion tjetër nuk kam pasur lidhur me ndonjë procedim penal në ngarkim të këtij shtetasi, por bashkëlidhur ju vë në dispozicion materialet provuese lidhur me barrën e provës."

Subjekti ka bashkëlidhur:

- Shkresë nr. *** prot., datë 27.05.2019 e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës;

Në këtë shkresë deklarohet se: Në lidhje me çështjen penale nr. *** datë 21.12.2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i K. Penale rezulton se për këtë procedim nuk është marrë as si person nën hetim dhe as si i pandehur shtetasi E. N.;

- Shkresë nr. *** prot., datë 24.06.2013 të Prokurorisë së Përgjithshme;

Në këtë shkresë deklarohet se subjekti i rivlerësimit, me dekret të Presidentit nr. ***, datë 18.06.2014, është emëruar prokuror në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

Komisioni vlerëson se bazuar në nenin 287⁴ të K.Pr. Penale, që personi të konsiderohet person i proceduar penalisht, duhet që t'i regjistrohet emri në regjistrin e njoftimit të veprës penale. Për sa më sipër, për sa kohë për veprën penale të parashikuar nga nenin 287 i K. Penal, shtetasi E. N., nuk rezulton t'i jetë vënë emri në regjistrin e njoftimit të veprës penale, ai nuk mund të konsiderohet si person i proceduar penalisht dhe rrjedhimisht, subjekti i rivlerësimit ka qenë i saktë në deklaratimet e tij në deklaratën për kontrollin e figurës. Gjithashtu nga ana e Komisionit nuk u arrit të provohej dijenia e subjektit të rivlerësimit në lidhje me procedimin për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i K. Penal për të cilën dyshohej si autor shtetasi E. N., pasi, nga të gjitha rrethanat, rezulton se ai nuk ka qenë në Durrës në kohën e fillimit të këtij procedimi, por ka qenë i emëruar në qytetin e Shkodrës.

2. Më datë 15.04.2019, pranë KPK-së ka mbërritur një denoncim nga shtetasi A. Dh., i cili, ndër subjekte të tjerë, denoncon se:

“Ndërkohë, vetë Elvin Gokaj, shefi i prokurorisë së Elbasanit, qëndronte në atë kohë në shtëpinë e A. B., i cili ka qenë i dënuar në Itali”.....

Në përgjigje të pyetësorit të bërë nga ana jonë, subjekti ka deklaruar se, gjatë kohës që ka punuar në Elbasan, familja e tij ka jetuar në Shkodër, ndërsa ai vetë ka jetuar në një banesë

⁴ 1. Prokurori shënon në regjistrë çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale. 2. Kur gjatë hetimeve paraprahe ndryshon cilësimi juridik ose ndonjë rrethanë e kryerjes së veprës penale, prokurori urdhëron pasqyrimin e tyre në shënimet e bëra sipas paragrafit 1 të këtij neni. 3. Ndalohet publikimi i regjistrimeve të bëra deri në marrjen si të pandehur të personit që i atribuohet vepra penale.

me OPGJ-në në banesën e një kushëriri të këtij të fundit, që ndodhet në lagjen “****”, kati i 5-të, Elbasan.

Komisioni konstaton se është e paqartë pronësia e kësaj banese të deklaruar nga subjekti, për këtë arsye iu kalua barra e provës për të depozituar pranë Komisionit, dokumentacion provues ligjor, si dhe shpjegime për apartamentin në të cilin ka banuar në Elbasan, për të provuar se ky apartament nuk është i njëjtë me atë të përmendur në denoncim.

Subjekti ka shpjeguar se : “Siç kam deklaruar edhe më parë, unë kam banuar me një OPGJ, të quajtur A. G. Për këtë ju dorëzoj vërtetimin e Prokurorisë Elbasan, me nr. *** prot., datë 27.05.2019, ku pasqyrohet periudha që ky shtetas ka ushtruar funksionet e OPGJ-së pranë kësaj prokurorie, konkretisht prej vitit 2005 deri në vitin 2018 kur është larguar me kërkesën e tij. Duke qenë se aktualisht OPGJ A. G., ndodhet jashtë shtetit, në Kanada, megjithë familjen e tij, kam arritur të vendos kontaktet me të dhe më ka vënë në dispozicion një deklaratë të cilën jua vë në dispozicion edhe juve.”

Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit një deklaratë noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.05.2019, të vëllait të OPGJ A. G., deklaratë e shtetasit A. G.

Subjekti ka vijuar sqarimin se: “Pasi u vura në dijeni përmes këtij relacioni për emrin e lartpërmendur, jam interesuar pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në lidhje me shtetasin A. B., nëse rezultonte ndonjë pronë në emër të tij dhe nga ata m'u vu në dispozicion një vërtetim me nr. *** prot., datë 27.05.2019, të cilin jua vë në dispozicion, sipas të cilit vërtetohet se në Drejtorinë Vendore Elbasan, nga kontrolli i regjistrave të pasurive të paluajtshme nuk figurojnë pasuri të regjistruara në emër të shtetasit A. B.

I jam drejtuar edhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për të më informuar nëse rezulton ndonjë çështje në vitin 2008 në ngarkim të ndonjë shtetasi të quajtur A. B., dhe me shkresën nr. *** prot datë 27.05.2019 më është kthyer përgjigje se nga verifikimi manual i bërë në regjistrat e njoftimit të veprave penale dhe procedimeve penale rezultoi se ndaj shtetasit A. B., nuk është regjistruar ndonjë material hetimor apo procedim penal për periudhën janar — dhjetor 2008.

Për sa më sipër, ju risqaroj edhe një herë se nuk kam asnjë njohje me pronarin e banesës ku kam qëndruar në Elbasan, përgjatë vitit 2008, pasi unë jam ftuar për të qëndruar sipas rastit në këtë banesë nga shtetasi A. G., me detyrë OPGJ në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Në respektim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksi, neni DH, është përcaktuar se subjektet e rivlerësimit plotësojnë dhe i dorëzojnë Komisionit një deklaratë të detajuar për figurën e tyre që mbulon periudhën nga data 01 janar 2012 deri në ditën e deklarimit, sipas ligjit.

Pra, siç mund të konstatohet lehtësisht, periudha në të cilën kam qëndruar me OPGJ A. G., në Elbasan, ka qenë në vitin 2008 dhe nuk përfshihet në periudhën e kërkuar. Gjithashtu nuk e lidh shtetasin A. B., me ndonjë procedim penal për të cilin unë të kisha dijeni apo me ndonjë pronë në emër të tij (bashkëlidhur dokumente mbështetëse, 19 fletë)”.

Subjekti ka bashkëlidhur:

1. Vërtetim nr. *** prot., datë 27.05.2019, i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

Bazuar në këtë vërtetim rezulton se z. A. B., nuk ka të regjistruar pasuri të paluajtshme në Qytetin e Elbasanit.

2. Shkresë nr. *** prot., datë 27.05.2019 e prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Bazuar në këtë shkresë rezulton se për periudhën janar-dhjetor 2008 nuk është regjistruar ndonjë material hetimor apo procedim penal për shtetasin A. B.

3. Vërtetim nr. ***, datë 27.05.2019 i prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Bazuar në këtë vërtetim rezulton se z. A. G., ka qenë në detyrën e OPGJ-s deri në datë 29.03.2018.

4. Deklaratë noteriale nr. *** datë 28.05.2019 e z. A. G., i cili deklaron se:

“...Kam jetuar në një banesë në lagjen “****” Elbasan, apartament në pallat, kati i ***. Vëllai im...për shkak të orëve të zgjatura të punës ndonjëherë e kishte të pamundur të kthehej mbrëmjeve vonë në Peqin dhe për këtë shkak nisi të jetonte përgjatë vitit 2008 në banesën në të cilën jetoja edhe unë...Vëllai im...i cili tashmë jeton në Kanada...ka ftuar shefin e vet pra, Elvin Gokaj që të vinte të flinte në shtëpinë, të cilën e kisha unë në përdorim...Kur jemi pyetur nga Z.Elvin Gokaj se e kujt është shtëpia, i kemi thënë se ishte e një kushërirsë tonë. Shtëpia me sa jam në dijeni unë ka qenë në emër të një shtetasje të quajtur V. Shtëpinë...e ka gjetur një mik i prindërve i quajtur V. T., për të cilën tashmë jam në dijeni se është në Amerikë, por nuk kam kontakte me të. V., i ka thënë V., për mua...Mua më kanë lënë të jetoja pa paguar para, më shumë me qëllim që shtëpia të kishte njerëz...z. Elvin Gokaj ka jetuar për një periudhë të shkurtër në këtë banesë dhe nuk ka pasur ndonjëherë kontakte me V., apo V...”

5. Diplomë e Nivelit të Parë e z. A. G., nga ku rezulton se ai ka filluar studimet në vitin 2006-2009;

6. Diplomë Master Profesional, viti 2010-2011;

7. Deklaratë e A. G., i cili deklaron se:

“Aktualisht jetoj bashkë me bashkëshorten në Kanada. Përgjatë periudhës 2005-2018 kam punuar si OPGJ në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan...Për shkak të ngarkesës më është dashur të flija në Elbasan. Vëllai im.. ka qenë student në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”... në periudhën 2006-2009...Përgjatë vitit 2008 ka jetuar në një banesë të ndodhur në lagjen “****” Elbasan, apartament në pallat, kati i ***. Për gjatë vitit 2008, duke qenë se shpesh më duhej të qëndroja në Elbasan për shkak të punës, kam shkuar dhe unë të banoja aty. Në vitin 2008 z. Elvin Gokaj ka ardhur të punonte si Drejtues i Prokurorisë së Elbasanit. Meqenëse familja e tij jetonte në Shkodër dhe nuk kishte ku të rrinte i kam propozuar të vinte të flinte në banesën që përdorte vëllai im dhe unë. Kur z. Elvin më ka pyetur se e kujt ishte banesa e kam bërë me dije se ishte e një kushërirsë sonë, pa i dhënë sqarime, pasi nuk i kam kushtuar rëndësi. Në dijeninë time banesa ka qenë e një gruaje të quajtur V., dhe prindërit e mi kishin miqësi me një shtetas të quajtur V. T., për të cilin e di që tashmë është në Amerikë. V., ka gjetur shtëpinë kur i duhej vëllait tim... z. Elvin Gokaj ka jetuar për një periudhë të shkurtër në këtë banesë dhe nuk ka pasur ndonjëherë kontakte me V., apo V...”

8. Certifikatën e sigurisë për njohjen me informacion të klasifikuar “tepër sekret”;

9. Urdhër nr. ***, datë 16.05.2013 për aktivizimin me shërbim të efektivave të FLO-së’

10. Urdhër nr. ***, datë 05.08.2013 për vazhdim shërbimi të efektivave të “FLO”-së.

11. Urdhër nr. ***, datë 14.11.2013 për aktivizimin me shërbim të efektivave të “FLO”-së

Nga dokumentacioni i depozituar provohet se z. A. B., nuk ka pasuri të paluajtshme në qytetin e Elbasanit, si dhe nga ana e subjektit është depozituar dokumentacion provues që vërteton se ai nuk ka jetuar në shtëpinë e shtetasit A. B.

Duke e konsideruar procesin e rivlerësimit një proces kushtetues që, megjithëse përfshin edhe kufizimin e të drejtave të subjekteve të rivlerësimit, kërkohet që ai gjithnjë duhet të kryhet në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, raporti për subjektin e rivlerësimit

duhet të jetë konkret, sa më i qartë, mbështetur në të dhëna të sakta, që provojnë lidhjet e subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, lidhje këto që mund ta bëjnë edhe subjektin e rivlerësimit lehtësisht të ndikueshëm prej tij. Nuk u provua në ndonjë formë që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, nuk është i përfshirë, si dhe nuk është i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë, ai është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe vlerësimit të provave dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni vlerëson se subjekti ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, si dhe nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar në kuptim të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se, në lidhje me vlerësimin e figurës, subjekti është i përshtatshëm për të vazhduar detyrën.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- A. Raportin për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga Prokuroria e Përgjithshme⁵;
- B. Denoncimet e paraqitura pranë Komisionit, si dhe dosjet e administruara prej tij.

Hetimi i kryer nga Komisioni si më poshtë:

- Shkresë, nr. *** prot., datë 19.06.2019 Prokurorisë Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan;

Prokuroria Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan na vuri në dispozicion dosjet përkatëse me shkresat nr. *** prot., datë 26.06.2019; nr. *** prot., datë 25.06.2019; nr. *** prot., datë 27.06.2019; nr. *** prot., datë 28.06.2019; nr. *** prot., datë 25.06.2019.

- Shkresë, nr. *** prot., datë 07.11.2018, drejtuar Prokurorisë Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan;

Kthim përgjigjeje i Prokurorisë Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, nr. *** prot., datë 19.11.2018.

- Shkresë, nr. *** prot., datë 07.11.2018, drejtuar Prokurorisë Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;

Kthim përgjigjeje i Prokurorisë Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nr. *** prot., datë 13.11.2018.

- Shkresë, nr. *** prot., datë 22.11.2018, drejtuar Prokurorisë Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan;

Kthim përgjigjeje i Prokurorisë Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, nr. *** prot., datë 26.11.2018.

⁵ Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- 1) Formularit të vetëvlerësimit dhe të *tri* dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëvlerësimit që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit;
- 2) Pesë dosje penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor me short;
- 3) Të dhëna nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme;

Raporti bazohet në kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

➤ Shkresë, nr. *** prot., datë 22.11.2018, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme
Kthim përgjigjeje i Prokurorisë së Përgjithshme, nr. *** prot., datë 26.11.2018.
Kthim përgjigjeje i Prokurorisë së Përgjithshme, nr. *** prot., datë 09.01.2018.

A. Pasi u shqyrtua raporti i përgatitur nga grupi i punës i Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe dosjet e administruara, ka rezultuar se:

1. **Në lidhje:** *Konkluzione përfundimtare para Gjykatës së Apelit Shkodër, për vendimin penal nr. ***, datë 02.04.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, dokument i depozituar nga vetë subjekti.*

Ky konkluzion përfundimtar është përpiluar dhe nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të Apelit në Prokurorinë e Apelit Shkodër, në lidhje me ankimin e bërë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër ndaj vendimit penal nr. ***, datë 02.04.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.

Nga ana e Gjykatës së Apelit Shkodër është marrë vendimi nr. ***, datë 15.09.2014, me të cilin është vendosur ndryshimi i vendimit nr. ***, datë 02.04.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, duke deklaruar fajtor të pandehurin për veprën penale të “Vrasjes me paramendim për hakmarrje”, parashikuar nga neni 78/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 20 vjet burgim për këtë akuzë;

Nga shqyrtimi i dosjes nga ana e Komisionit, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë analizë të hollësishme lidhur me figurat e veprave penale të “Vrasje me paramendim”, e parashikuar nga neni 78/2 i Kodit Penal dhe “Vrasje me dashje”, e parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal. Në lidhje me këtë konstatim Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit, i cili, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, ka sqaruar se:

“Prokurori në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër ka paraqitur ankim dhe në Prokurorinë e Apelit Shkodër, organi i akuzës është përfaqësuar prej meje. Ankimi i prokurorit është përkrahur nga ana ime. Nga ana ime është mbështetur ankimi i prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër. Analiza e veprës penale është bërë pikërisht mbështetur në rrethanat e faktit dhe provat e administruara, fakt që tregohet më së miri nga qëndrimi i Gjykatës së Apelit Shkodër, e cila ka bërë ndryshimin e cilësimit ligjor, duke u arritur deklarimi fajtor i pandehuri pikërisht për akuzën që i ishte ngritur nga prokurori.”

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit vlerëson se ato nuk janë bindëse dhe nuk janë të mbështetura në prova apo ligjin procedural penal. Në këtë dokument ligjor Komisioni ka konstatuar njohuri të cekëta të subjektit në lidhje me figurat e veprës penale të parashikuar nga neni 78/2 dhe 76 i Kodit Penal. Subjekti nuk është thelluar në arsyetim, duke reflektuar njohuri të cunguara, të cilat konsiderohen mangësi profesionale.

2. **Në lidhje:** *Konkluzionet përfundimtare çështje themeli (dosja nr.2 e zgjedhur me short), pa rekurs, nr. *** vendimi dhe datë 15.02.2016.*

Konkluzioni përfundimtar është përpiluar dhe nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të apelit në Prokurorinë e Apelit Shkodër, në lidhje me ankimin e bërë nga e pandehura ndaj vendimit penal nr. *** datë 05.03.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.

Pas shqyrtimit të dosjes nga Komisioni, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë analizë të hollësishme e provave të administruara dhe argumenteve për të kundërshtuar ankimimin e kryer nga e pandehura.

Në lidhje me këtë konstatim, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit, i cili, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, ka sqaruar se:

“Në lidhje me këtë gjetje bëj me dije se nga ana ime është vlerësuar i drejtë vendimi i gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe është mbështetur ky vendim. Nuk mund të ripërsërisja në detaje vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, pasi në rastin konkret është detyrë e palës që ankimon të bëjë një analizë të kundërt të situatës, meqënëse ajo kërkon ndryshimin e vendimit. Për më tepër, vetë në relacion është pasqyruar se unë kam një parashtrim të argumentave përse ankimi nuk duhet të pranohet.”

Komisioni pasi analizoi shpjegimet e subjektit vlerëson se ato nuk janë bindëse dhe nuk janë të mbështetura në prova apo ligjin procedural penal. Subjekti nuk mund të mbështetet në vendimin e gjykatës për të hartuar konkluzionet e tij, por ai, në bazë të ligjit procedural penal, duhet të analizojë në mënyrë të detajuar provat e administruara dhe të japë argumentet e tija ligjore, si përfaqësues i organit të akuzës, në emër të shtetit shqiptar, me qëllim vendosjen para drejtësisë të personave që kanë kryer vepra penale, duke mbrojtur në këtë mënyrë interesin publik.

Në përfundim, Komisioni konstaton se në këtë dokument ligjor subjekti ka shfaqur njohuri të cekëta dhe gjykim të dobët në lidhje me analizimin e provave të administruara dhe paraqitjes së argumentave për mospranimin e ankimit, të cilat konsiderohen mangësi profesionale.

3. Në lidhje me: *Konkluzionet përfundimtare, çështje themeli(dosja nr.4 e zgjedhur me short), me rekurs, me nr. *** vendimi dhe datë 17.07.2014.*

Konkluzioni përfundimtar është përpiluar dhe nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të apelit në Prokurorinë e Apelit Shkodër, në lidhje me ankimin e bërë nga prokuroria ndaj vendimit penal nr. ***, datë 25.03.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë.

Grupi i punës së Prokurorisë së Përgjithshme ka konstatuar se nuk është bërë analizë e hollësishme juridike e figurës së veprës penale të “Dhuna në familje” e parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, si dhe ndërthurja e saj me rrethanat e faktit. Gjithashtu nuk është analizuar masa e dënimit të kërkuar.

Në lidhje me këtë konstatim, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit, i cili, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, ka sqaruar se:

“Në lidhje me këtë moment, ju sqaroj se nga ana ime është mbështetur ankimi i bërë nga prokurori në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë. Ashtu si me të drejtë është gjetur nga Komisioni, janë parashtruar rrethanat e faktit dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, si dhe janë paraqitur argumentat përse duhet të pranohet ankimi i prokurorit. Mendoj se qëndrimi im ka qenë i drejtë dhe janë paraqitur para gjykatës të gjithë elementët e nevojshëm.”

Komisioni pasi analizoi shpjegimet e subjektit vlerëson se ato nuk janë bindëse dhe nuk janë të mbështetura në prova apo ligjin procedural penal. Në këtë dokument ligjor, Komisioni, ashtu si edhe grupi i punës së Prokurorisë së Përgjithshme, ka konstatuar njohuri të cekëta dhe gjykim të dobët të subjektit në lidhje me figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, si dhe në analizimin e masës së dënimit të kërkuar nga ana e tij, të cilat konsiderohen mangësi profesionale.

4. Në lidhje me: *“Të dhënat arkivore lidhur me ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime”*

Nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e kallzimeve dhe Procedimeve Penale të Prokurorisë së Përgjithshme është evidentuar praktika nr. *** e vitit 2013, ankesë nga shtetasja E. K. (me detyrë Prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan).

Subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit më të lartë (Drejtues i Prokurorisë), nëpërmjet vendimit të datës 7.1.2012, ka shfuqizuar një vendim të prokurorit të çështjes znj. E. K. (mbi pushimin e procedimit penal nr. *** /2012) dhe e ka zëvendësuar atë me një prokuror tjetër. Për sa i përket zëvendësimit të prokurorit të çështjes znj. E. K., subjekti i rivlerësimit në vendimin e tij argumenton se: *“...Nga ana e kallzuesit janë ngritur pretendime për njëanshmëri të hetimit nga ana e Prokurorisë së çështjes, ndodhur në këto kushte, për një hetim sa më objektiv dhe të gjithanshëm, për të shmangur çdo lloj paragjykimi, lindi e domosdoshme dhe zëvendësimi i prokurores.”*

Në bazë të nenit 27 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori më i lartë zëvendëson prokurorin e çështjes, bazuar në arsye serioze. Ndërsa në vendimin e subjektit të rivlerësimit nuk ka arsyetim bindës për arsyet serioze që e çuan në zëvendësimin e prokurores E. K.

Për sa më sipër rezulton se vendimi i subjektit për zëvendësimin e prokurorit nuk përmban elementet e parashikuara në nenin 27 të K.Penal, pasi mungon argumentimi. Në lidhje me këtë konstatim, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit, i cili, pas dërgimit të rezultateve të hetimit ka sqaruar se:

“...Kam argumentuar si më lart se prokurorja në vendimmarrje i ka tërhequr vëmendjen palës kallzuese, duke aluduar për arsyet përse kishte bërë kallëzim, kam parashtruar pretendimet e kallzuesit për bindjen e tij për njëanshmëri të hetimit. Pasur parasysh faktin se prokurorja e çështjes kishte shprehur tashmë bindjen e saj për faktin, në mënyrë që në vijim të mundësohej kryerja e një hetimi sa më objektiv dhe të gjithanshëm, për të shmangur çdo lloj paragjykimi nga palët, pasur parasysh qëndrimin e Gjykatës Evropiane të Strasburgut, sipas të cilit "Drejtësia jo vetëm duhet të jepet, por edhe të duket se po jepet", kam vlerësuar zëvendësimin e saj. Për sa kohë prokurorja e kishte shprehur mendimin e vet në lidhje me faktin e kallëzuar, kishte dhënë madje mendim edhe mbi motivet që kanë shtyrë kallzuesin për të paraqitur kallëzim, kishte krijuar një imazh se prej saj, pritej e njëjta vendimmarrje. Pavarësisht qëndrimit që mund të kishte në vijim prokurorja, fakti se ajo kishte pasur bindjen në vendimmarrjen e mëparshme të saj, do të sillte paragjykim. Prokurorja është njohur me vendimmarrjen time, nuk i është mohuar asnjë e drejtë, ka pasur të drejtën e ankimit dhe e ka ushtruar atë. Dhënia e një vendimi si në rastin konkret nga prokurorja, duke konkluduar se ekspertimi i rremë nuk ekziston, dhe bindja e saj se kallëzimi është përdorur nga kallzuesi si një mjet për t'i mundësuar bërjen e një kërkesë për rishikim, ka sjellë bindjen tek kallzuesi se është paragjykuar.”

Për të mbështetur shpjegimet e tij, subjekti ka bashkëlidhur:

- Vendim për pushimin e procedimit penal nr. *** /viti 2012, të datës 08.04.2013 të prokurores E. K.;
- Shkresë, nr. *** prot., datë 28.03.2013, të Prokurorisë së Përgjithshme;
- Vendim, datë 25.03.2013, të Prokurorit të Përgjithshëm, i cili ka vendosur:
 - “Pranimin pjesërisht të ankimit të Prokurores E. K., ndaj vendimit datë 07.01.2013 të drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan “Për shfuqizimin e vendimit të pushimit të çështjes penale nr. ***, vitit 2012 dhe zëvendësimin e prokurores.”
 - Shfuqizimin e vendimit të drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan të datës 07.01.2013 “Për shfuqizimin e vendimit të pushimit të çështjes penale nr. ***, viti 2012 dhe zëvendësimin e prokurores.”

Komisioni konstaton se në këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm argumenton:

“Vendimi i drejtuesit të prokurorisë datë 07.01.2013, për shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***, datë 23.10.2012 **është i paarsyetuar, i pabazuar në rrethana fakti të provuara dhe i pabazuar në ligj**, arsye për të cilat duhet shfuqizuar.

Drejtuesi i Prokurorisë në kuadrin e mbikëqyrjes dhe kontrollit të ligjshmërisë për mënyrën e përfundimit të hetimeve të këtij procedimi penal, ka vendosur shfuqizimin e vendimit datë 23.10.2012 të pushimit të hetimeve të kësaj çështje **pa analizuar dhe vlerësuar drejt** provat dhe indiciet e administruara nga hetimi paraprak, si dhe **në kuptim e interpretim të gabuar si të ligjit procedural penal, respektivisht të neneve 2,1,24, pika 1, 277, 290, pika 1, germa “d”, 327, pika 1 dhe 328, pika 1 germa “d” të K.Pr. Penale, ashtu dhe të ligjit material penal, nenit 309 në lidhje me nenin 66/c të K.Penal.**

Argumentimi i përdorur në arsyetimin e vendimit për vazhdimin e hetimeve meqenëse procedimi penale është regjistruar, jo vetëm që nuk është i mjaftueshëm për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese, por bie në kundërshtim me rrethanat e faktit, të rezultuara nga hetimi paraprak i kryer dhe me ligjin.

Në vendimin e tij drejtuesi nuk ka arsyetuar mungesën e shkaqeve ligjore për pushimin e çështjes, për mungesë të faktit.

Drejtuesi i Prokurorisë ka **zëvendësuar** prokuroren e çështjes **në vlerësim, kuptim dhe interpretim të gabuar** jo vetëm të faktit dhe të pretendimeve të ngritura nga pala kallëzuese për njëanshmëri të prokurores së çështjes për moskryerje të veprimeve të kërkuara, por dhe në kuptim dhe interpretim të gabuar të ligjit, nenit 27/1 në lidhje me nenin 17 të K.Pr. Penale. Ai nuk ka arsyetuar bazuar në rrethana fakti dhe në ligj se cilët janë shkaqet serioze që lidhen me detyrën dhe që nuk janë zbatuar me objektivitet dhe paanshmëri nga prokurorja e çështjes në këtë procedim penal.”

Siç rezulton nga sa më sipër vendimi i subjektit të rivlerësimit është konstatuar dhe nga Prokurori i Përgjithshëm si i nxjerrë në shkelje të ligjit, ky vendim i Prokurorit të Përgjithshëm nuk rezulton të jetë i ankimuar nga subjekti i rivlerësimit dhe rrjedhimisht, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk mund të merren në konsideratë.

Komisioni vlerëson së sërish subjekti i rivlerësimit ka paraqitur njohuri të cekëta dhe gjykim të dobët lidhur me ligjin procedural penal si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij si drejtues i Prokurorisë, e cila konsiderohet mangësi profesionale.

B. Denoncimet e paraqitura pranë Komisionit, si dhe dosjet e administruara prej tij.

1. Lidhur me procedimet penale nr. * dhe ***, të vitit 2010 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan**

Në bazë të nenit 41, pika 4, nenit 43, pika 4, nenit 49, germa “a” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shkresë nr. *** prot., datë 07.11.2018 u kërkua nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan për vendime mosfillimi apo pushimi të procedimeve penale nga subjekti i rivlerësimit në periudhën në të cilën ai ka drejtuar këtë prokurori (shkurt 2008 – tetor 2013).

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan me shkresën nr. *** prot., datë 19.11.2018 informoi se gjatë kësaj periudhe subjekti kishte vetëm një vendim pushimi të ndjekjes penale për veprën penale të “Korrupsionit pasiv nga persona që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i K. Penal në ngarkim të shtetasit K. K., që në atë kohë mbante postin e drejtorit të ZVRPP-së Elbasan. Procedimi penal i pushuar është ai me nr. *** i vitit 2010. Ky procedim ishte ndarë nga procedimi nr. *** i vitit 2010, i cili ishte dërguar në gjykim ndaj dy të pandehurve për veprën penale “Ushtrim të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 245/1 i K. Penal.

Në cilësinë e organit të vlerësimit të aftësive profesionale, Prokurorisë së Përgjithshme, me shkresën nr. *** prot., datë 22.11.2018 iu kërkua një vlerësim në lidhje me:

- Verifikim në lidhje me arsyet që çuan në ndarjen e procedimit nr. *** të vitit 2010, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan;
- Mënyrën e përfshirjes së prokurorit Elvin Gokaj në hetimin e kësaj çështjeje;
- Raport profesional mbi hetimin dhe vendimarrjen e prokurorëve në lidhje me procedimin penal nr. *** të vitit 2010, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. *** prot., datë 09.01.2019 dërgoi opinion/interpretim ligjor mbi procedimet penale nr. *** dhe *** të vitit 2010 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan nga ku rezultoi se:

a. Arsyet që çuan në ndarjen e procedimit penal nr. * të vitit 2010 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan**

Duke iu referuar arsytimit të përdorur nga subjekti në vendimin e ndarjes së procedimit penal, rezultoi se vendimarrja është mbështetur në nenin 93/ pika 1 germa “ç” të K.Pr.Penale, në të cilin parashikohet “se kur për një a më shumë të pandehur ose për një a më shumë akuza hetimi është i plotë, kurse për të pandehurit e tjerë ose për akuzat e tjera është e nevojshme të kryhen veprime të tjera, vendoset ndarja e çështjes”.

- Referuar gjendjes së akteve të procedimit penal nr. *** /2010, dhe kërkesave të nenit 93 të K.Pr.Penale, nuk duhej të ishte vendosur ndarja e procedimit penal. Nga studimi i fashikullit rezultoi se deri në datën 10.05.2010, kur është vendosur dërgimi për gjykim i të pandehurve S. B., dhe A. B., si dhe është vendosur ndarja e procedimit penal në ngarkim të personit nën hetim K. K., hetimet nuk kanë qenë të plota dhe ishte konsumuar një kohë relativisht e shkurtër e afatit hetimor 3- mujor.

- Hetimi është dëmtuar qysh në momentin kur janë arrestuar në flagrancë shtetasit S. B., dhe A. B., dhe nuk kuptohet se cila ka qenë arsyeja që operacioni është “finalizuar” me arrestimin e dy personave të mësipërm, kur qëllimi final ka qenë dorëzimi i lekëve tek personi nën hetim, K. K. Në procesverbalin e kapjes në flagrancë, thuhet se operacioni “u ndërpre me urdhër të drejtuesit”, pa u specifikuar emri i drejtuesit të operacionit dhe arsyet e ndërprerjes. Sipas procesverbalit të kapjes në flagrancë datë 13.04.2010, ora 15:10, nuk del emri i drejtuesit të operacionit. (fq. 39-40 e fashikullit hetimor nr. *** viti 2010).

- Pavarësisht nga sa sipër, sipas nenit 277/2 të K.Pr.Penale, prokurori drejton hetimet, e në këto rrethana, edhe situata e prezantuar më lart, prezumohet që është kontrolluar dhe drejtuar nga subjekti i rivlerësimit.
- Vlerësojmë se, pas arrestimit në flagrancë të shtetasve S. B., dhe A. B., mund të ishte bërë përgjimi procedural ambiental midis tyre, me qëllim sqarimin e rrethanave të çështjes dhe marrjen e të dhënave mbi personin nën hetim K. K., veprim i cili, në rastin konkret nuk është kryer.
- Gjithashtu, pjesë e hetimit ka qenë edhe marrja e tabulateve telefonike të personave nën hetim, pasi nga materialet e dosjes rezulton se, për këtë qëllim, i është kërkuar informacion kompanive celulare. Qëllimi i kërkesës ka qenë për të provuar njohjet midis personave nën hetim dhe sidomos midis shtetasve A. B., dhe K. K. Megjithëse është bërë një kërkesë e tillë dhe pritej përgjigjja nga kompanitë celulare, vendimi i dërgimit të çështjes për gjykim dhe i ndarjes së procedimit penal, janë marrë pa u administruar përgjigjet, të cilat çmoheshin të rëndësishme për të verifikuar njohjen midis shtetasve A. B., dhe K. K., si dhe komunikimet e mundshme telefonike midis tyre në funksion të çështjes.
- Shtetasit K. K., i janë sekuestruar, por nuk janë këqyrur 2 aparate celularë (njëri me dy karta), ku nga policia gjyqësore është identifikuar vetëm numri i njërit prej telefonave, dhe kanë ngelur pa u identifikuar dy numrat e tjerë. Nuk rezulton të jetë pyetur shtetasi K. K., gjatë marrjes në pyetje në datën 13.04.2010, për të identifikuar 2 numrat e tjerë të aparateve që i janë sekuestruar, me qëllim për të verifikuar komunikimet e mundshme telefonike midis tij dhe shtetasit A. B., ditën e arrestimit në flagrancë të këtij të fundit apo edhe më parë.
- Nga ana tjetër, rezulton se hetimet për procedimin penal nr. *** vitit 2010 kanë zgjatur rreth 1 muaj (regjistruar procedimi penal datë 13.04.2010 dhe përfunduar 10.05.2010). Gjithashtu, edhe për procedimin penal *** viti 2010 hetimet kanë zgjatur rreth 1 muaj e 10 ditë nga data e regjistrimit të procedimit penal (nga data 20.05.2010 deri në 30.06.2010). Në këto rrethana, jo vetëm për shkak se nuk ishin kryer hetime të plota, por edhe për shkakun se nuk dëmtoheshin afatet e hetimit 3 mujor, vlerësojmë se çështja duhej të ishte zgjidhur si një procedim penal i vetëm.

b. Mënyra e përfshirjes së subjektit të rivlerësimit në hetimin e kësaj çështjeje

Përfshirja në hetim e subjektit të rivlerësimit, ka qenë që në momentin e administrimit në prokurori të materialit kallëzues nga policia gjyqësore. Regjistrimi i procedimit penal dhe i emrave të shtetasve në regjistrin e veprave penale janë kryer nga subjekti i rivlerësimit. Më tej, duke filluar nga momenti i arrestimit në flagrancë të shtetasve të sipërcituar, veprimet hetimore janë kryer nën drejtimin e tij dhe të prokurorit A. Sh. Vendimi për ndarjen e çështjes është përpiluar dhe nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, ndërsa vendimi i pushimit të çështjes në ngarkim të shtetasit K. K., është nënshkruar nga të dy prokurorët.

Nga shqyrtimi i akteve të dosjes vlerësojmë se:

Kodi i Procedurës Penale dhe aktet ligjore të kohës nuk parashikonin asnjë ndalim për përfshirjen në hetime/gjykime të drejtuesve të prokurorive të rretheve gjyqësore. Pothuajse, në të gjitha prokuroritë e rretheve gjyqësore, me përjashtim të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Prokurorisë për Krimet e Rënda Tiranë (për shkak të ngarkesës së madhe të punës në cilësinë e drejtuesit), drejtuesit e prokurorive të tjera janë angazhuar në hetime dhe gjykime, por më një ngarkesë më të reduktuar se prokurorët e tjerë.

Për sa më sipër, përfshirja e subjektit të rivlerësimit në hetimin e këtij rasti është i bazuar në dispozitat ligjore si dhe urdhrat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm.

c. Raport profesional mbi hetimin dhe vendimmarrjen e prokurorëve në lidhje me procedimin penal nr. * viti 2010**

Në hetimin e çështjes në tërësi, dhe në veçanti në lidhje me hetimin në ngarkim të shtetasit K. K., konstatohen mangësi dhe një menaxhim jo i drejtë i hetimit, të cilat kanë kushtëzuar vendimin e pushimit të procedimit penal në ngarkim të tij.

Hetimi i çështjes është dëmtuar qysh në momentin kur janë arrestuar në flagrancë shtetasit S. B., dhe A. B., dhe siç është arsyetuar më lart, nuk kuptohet se cila ka qenë arsyeja që operacioni është “finalizuar” me arrestimin e dy personave të mësipërm, kur qëllimi final ka qenë dorëzimi i lekëve tek personi nën hetim, K. K.

Për më tepër, ndërhyrja nga ana e policisë gjyqësore në momentin kur lekët i ka patur shtetasi S. B., pa ja dhënë “sekserit” A. B., në mungesë të provave të tjera, ka kompromentuar hetimin edhe në lidhje me akuzën e ngritur ndaj shtetasit A. B., të cilin gjykata e ka deklaruar të pafajshëm.

Për sa më sipër, është e vështirë të konkludohet se si do të kishte përfunduar zgjidhja e çështjes nëse do të ishin kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, por në gjendjen aktuale të akteve të procedimeve penale nr. *** dhe nr. *** viti 2010, vlerësojmë se vendimi i pushimit të procedimit penal në ngarkim të shtetasit K. K., është rrjedhojë e një hetimi jo të plotë.

Komisioni bazuar dhe në vlerësimin e mësipërm konstatoi se subjekti nuk ka reflektuar aftësi në procedurat hetimore të kësaj çështje, duke çuar në vendim pushimi të procedimit penal.

Në lidhje me këtë konstatim, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit, i cili, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, ka sqaruar se:

“Në lidhje me këtë procedim, angazhimi im ka qenë i plotë dhe me përkushtim duke marrë masa për rregjistrimin e materialit hetimor. Duke qenë se në kushtet e ushtrimit të funksionit tim si Drejtues Prokurorie, kam qenë i angazhuar në një tërësi detyrash të tjera, është angazhuar në veprime të mëtejshme hetimore edhe një prokuror tjetër i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Gjetjet se dëmtimi është hetuar që në momentin që janë arrestuar në flagrancë shtetasit S.B. dhe A. B. nuk ka qenë si pasojë e ndërhyrjes sime apo e prokurorit tjetër, por tregon dukshëm se ka qenë vlerësimi i policisë gjyqësore për të kapur në flagrancë personat e dyshuar që po kryenin aktin korruptiv. Në bazë të nenit 251 të K.Pr.Penale, arrestimi në flagrancë është atribut i policisë gjyqësore. Atribut i prokurorit është ndalimi, sipas nenit 253 të K.pr.Penale, dhe në rastin konkret mund të konstatohet lehtësisht që nuk është bërë asnjë veprim nga ana ime për të ndërprerë operacionin, i cili në terren kryhet nga policia gjyqësore.

Referuar nenit 2941/a të K.Pr.Penale "Veprimet simuluese" konstatojmë se legjislatori ka parashikuar: Oficeri dhe agjenti i policisë gjyqësore ose personi i autorizuar prej tyre mund të ngarkohen për: blerje të simuluar të sendeve që rrjedhin nga një krim ose simulim i një akti korruptiv, ose të kryejnë veprime të tjera simuluese, për të zbuluar të dhëna financiare ose pronësie të një personi, për të cilin ka dyshime për kryerjen e një krimi, duke fshehur bashkëpunimin me policinë, ose detyrën e tyre si punonjës policie.

Këto veprime bëhen me autorizimin e prokurorit që kontrollohet hetimet ose të prokurorit që ka në juridiksion territorin ku do të zhvillohet veprimi. Pas kryerjes së këtyre veprimeve, policia gjyqësore duhet t'i dorëzojë prokurorit të gjitha provat e mbledhura dhe një raport përmbledhës

Pra, prokurori jep autorizim, por të gjitha veprimet në terren kryhen nga policia gjyqësore e cila informon prokurorin me një raport përmbledhës dhe i vë në dispozicion provat e mbledhura.

Në aktet nënligjore, megjithëse nuk ka një parashikim të mirëfilltë për veprimin simulues për kryerjen e një akti korruptiv, në të vërtetë ka ekzistuar një udhëzim i përbashkët mes Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Rendit Publik për përdorimin e metodave speciale të hetimit të krimeve kundër drogës, që i përket muajit prill të vitit 2003. Në këtë udhëzim, përcaktohet se pasi merret leja nga prokurori përgjegjës për realizimin e metodës se blerjes së simuluar, Shërbimi Qendror i Luftës Kundër Drogës harton planin e operacionit, të cilin e miraton Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Në rastet kur do të gjykohet e nevojshme se zhvillimi i mëtejshëm i operacionit paraqet rrezik për jetën e pjesëmarrësve ose për të dështuar operacioni, drejtuesi i tij e ndërpret operacionin, duke informuar menjëherë prokurorin përgjegjës si dhe Drejtorin e Policisë Kriminale.

Pra siç mund të konstatohet, drejtuesi i operacionit nuk është prokurori.

Në lidhje me pjesën se duhet të ishni kryer veprime hetimore për të verifikuar faktin nëse kishte njohje mes të pandehurit A.R. dhe shtetasit K.K. në të vërtetë veprimet janë kryer dhe ka rezultuar të provohet se kjo njohje ekzistonte, por nuk shërbente për ngritjen e një akuze ndaj të dyshuarit K.K. (shihni faqja 3 e vendimit të pushimit datë 30.06.2010).

Nga të gjitha provat e administruara nuk ka rezultuar të provohej se shtetasi K.K. kishte konsumuar veprën penale për të cilën u dyshua.”

Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë bindëse dhe nuk mbështeten në prova. Në shpjegimet e tij ai është përqëndruar vetëm në faktin që ai nuk ka qenë drejtuesi i operacionit, ndërkohë në lidhje me gjetjet e tjera ai nuk ka dhënë shpjegime.

Në këtë procedim, nga ana e tij, siç është konstatuar më lart, nuk janë kryer të gjitha veprimet hetimore, duke treguar njohuri dhe aftësi të cekëta si dhe gjykim të dobët për kryerjen e procedurave dhe veprimeve të nevojshme hetimore me qëllim vendosjen përpara drejtësisë të personave që kanë kryer vepra penale, të cilat konsiderohen mangësi profesionale.

2. Në lidhje me materialin kallëzues nr. * /2014 dhe procedimit penal nr. *** /2013**

Me shkresën nr. ***, datë 12.07.2018 Prokuroria e Përgjithshme midis të tjerave i ka vënë në dispozicion Komisionit, materialin hetimor nr. *** të datës 19.08.2014 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, për veprën penale “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i K. Penal, në ngarkim të Elvin Gokaj, për të cilin është marrë vendimi i mosfillimit.

Më datë 18.08.2014 shtetasit K. M. dhe A. M., kanë paraqitur kallëzim penal ndaj prokurorit Elvin Gokaj për veprën penale “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i K. Penal, lidhur me ngjarjen e datës 17.12.2013 gjatë hetimit të tyre nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Prokurori Elvin Gokaj është larguar nga Prokuroria Durrës më 15.06.2014.

Është kërkuar nga ana jonë kopje e procedimit penal nr. *** /2013 e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

Në formularin për kontrollin e ushtruar në dosjen penale *** /2013 zëvendësprokurori i Rrethit ka konstatuar se “Caktimi i avokatit kryesisht vetëm për përfundimin e hetimeve apo njoftimin e kërkesës për gjykim, gjykojmë se është i panevojshëm, pasi avokati me prokurë i

caktuar nga të pandehurit ka refuzuar të firmosë, e në këto kushte duhej t'i kërkohej të hiqte dorë ose të paraqitej kërkesë me shkrim, në të kundërt duhej njoftuar Dhoma e Avokatisë për mënyrën e sjelljes”.

Objeksionet e Prokurorit të Rrethit lidhur me këtë dosje janë “Sa i përket caktimit të avokatit kryesisht duhej bërë zëvendësim dhe njoftim për zgjedhjen e avokatit Dhomës Kombëtare të avokatisë dhe duhet bërë ky njoftim”.

Në aktet e procedimit nr. *** /2013 për të dy të pandehurit gjenden nga dy procesverbale për njohjen me aktet. Dy prej procesverbale janë mbajtur nga ana e oficerit të policisë gjyqësore më 26.03.2014 dhe dy të tjerë janë mbajtur nga ana e prokurorit të çështjes subjektit të rivlerësimit një ditë më pas.

Në dy procesverbalet e mbajtura nga ana e oficerit të policisë gjyqësore të pandehurit dhe avokati i tyre kanë refuzuar të firmosin.

Më datë 27.03.2014 prokurori i çështjes, subjekti i rivlerësimit, ka marrë vendim për caktimin e mbrojtësit kryesisht pa bërë një arsyetim se përse ka caktuar avokat kryesisht kur të pandehurit kanë avokat të zgjedhur me prokurë të posaçme.

Po më 27.03.2014 ora 09.³⁰ avokatja e caktuar kryesisht firmos njoftimet e akuzave të dy të pandehurve. Të dy procesverbalet për njohjen e të pandehurit me aktet të datës 27.03.2014 të mbajtura nga prokurori i çështjes Elvin Gokaj janë firmosur nga avokati i caktuar kryesisht pasi njihet me ato nga ora 08.³⁰ deri në 09.³⁰. Në dosje nuk rezulton që caktimi i avokatit kryesisht t'i jetë njoftuar të pandehurëve, të cilët ndodheshin në paraburgim, pasi ata mund të zgjidhnin një tjetër mbrojtës ose të mos ishin dakord për zgjedhjen e mbrojtësit kryesisht nga prokurori për arsye të ndryshme. Gjithashtu subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar nenin 57 të K. Pr. Penale për t'i dhënë mbrojtësit të ri një afat i përshtatshëm për t'u njohur me aktet dhe provat, pasi në vetëm një orë, avokatja kryesisht është njohur me fashikullin që përbëhej prej 313 faqesh. Në procesverbalet e përfundimit të hetimeve dhe njohjes me aktet të firmosura nga avokatja e caktuar kryesisht në rubrikën i pandehuri nuk ka nënshkrim, por thuhet “refuzuar”.

Në bazë të nenit 56 të K. Pr. Penale subjekti i rivlerësimit duhet të referonte në këshillin drejtues të Dhomës së Avokatëve lidhur me refuzimin e mbrojtjes nga ana e avokatit R.Xh. Megjithëse këtë vërejtje ja kanë bërë edhe drejtuesit e prokurorisë, ai nuk e ka zbatuar.

Në aktet e procedimit nr. *** /2013 gjendet urdhri për shpërblimin e avokatit të caktuar kryesisht që mban datën 24.02.2014, pra më shumë se një muaj përpara se ai të vendoste caktimin e mbrojtësisht kryesisht më datë 27.03.2014.

Komisioni në përfundim konstaton se subjekti duket ka shkelur të drejtat e të pandehurve në lidhje me zëvendësimin e avokatit të zgjedhur prej tyre me një avokate të zgjedhur kryesisht, duke mos ndjekur procedurë të rregullt.

Në lidhje me këtë konstatim, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit, i cili, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, ka sqaruar se:

“ Jam dakord me gjetjet e Komisionit për sa i përket faktit se në proces verbalet e mbajtura nga OPGJ për njohjen me aktet, të pandehurit dhe avokati i tyre ka refuzuar të firmosin. Në fakt kjo është një e drejtë e tyre dhe veprimet e mia si prokuror mund të kishin përfunduar edhe aty. Është një mënyrë që zgjedhin të pandehurit dhe avokati i tyre, për të realizuar mbrojtjen.

Referuar nenit 117 të K.Pr.Penale, procesverbali i mbajtur në formë të shkruar, me përjashtim të atij që mbahet në seancën gjyqësore, pasi lexohet, nënshkruhet në fund të çdo flete nga ai që e ka përpiluar, nga ai që procedon dhe nga personal që kanë marrë pjesë.

Kur njëri nga pjesëmarrësit nuk do ose nuk është në gjendje të nënshkruajë, bëhet vërejtje ku tregohet edhe shkaku.

Megjithatë, me qëllim për t'i ofruar një garanci më të madhe dhe më të plotë të pandehurve, kam vlerësuar caktimin e avokatit kryesisht. Edhe qëndrimi i zëvendës drejtuesit ka qenë që caktimi i mbrojtësi kryesisht ka qenë i panevojshëm, por jo se ka cënuar ndonjë të drejtë të të pandehurve. Përkundrazi atyre u është ofruar një mbrojtje nga avokati i zgjedhur prej tyre, ashtu si edhe nga një mbrojtës i caktuar kryesisht. Në vijim të këtij arsyetimi, nuk qëndron as gjetja se në respektim të nenit 57 të K.Pr.Penale, mbrojtësit të ri nuk i është dhënë një afat i përshtatshëm për t'u njohur me aktet dhe provat. Mbrojtësi i caktuar kryesisht nuk e ka ngritur një pretendim te tillë, për më tepër, që mbrojtësi i zgjedhur nga të pandehurit, megjithëse i është dhënë si mundësi, bashkë me të pandehurit, kanë refuzuar të nënshkruajnë procesverbalin e njohjes. Nënshkrimi apo jo, nuk tregon se ata nuk janë njohur me aktet por thjesht nuk kanë dëshiruar ta pasqyrojnë këtë fakt. As në gjykim nuk është parashtruar ndonjë kërkesë për pavlefshmëri ose papërdorshmëri të akteve. Ndërkohë përsa i përket datës së gjendur në urdhërin për shpërblimin e mbrojtësit, që sipas gjetjeve të komisionit, është një muaj para se të caktohej mbrojtësi kryesisht, është thjesht një lapsus, për shkak të ngarkesës së punës, përgatitjes së dokumentit mbi një dokument të mëparshëm, duke mbetur gabimisht data e dokumentit të mëparshëm.”

Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë bindëse dhe nuk mbështeten në prova. Mbetet fakt që nga ana e tij nuk janë respektuar dispozitat e K.Pr. Penale në lidhje me të drejtën e të pandehurit për të zgjedhur lirisht mbrojtësin e tij, si dhe me dhënien e një afati të arsyeshëm mbrojtësit për njohjen me dosjen. Afati prej 1 ore nuk mund të jetë i mjaftueshëm për mbrojtësin për t'u njohur me një dosje voluminoze. Në përfundim konstatohen njohuri të cekëta të subjektit të rivlerësimit, duke mos respektuar normalisht të drejtat e të pandehurit dhe të mbrojtësit, të cilat konsiderohen mangësi profesionale.

3. Lidhur me fashikullin nr. * të vitit 2012 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan**

Nga verifikimi në mediat e shkruara rezultoi se në datën 09.05.2012 gazeta “Panorama” ka publikuar një shkrim lidhur me ngjarjen e datës 05.05.2012 në stadiumin e “Shkumbinit” në Peqin ku dyshohej se shtetasi D. S., ka qëlluar me pistoletë në dhomat e arbitrave para fillimit të ndeshjes “Shkumbini – Flamurtari”. Në këtë shkrim rezulton se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan në atë kohë është prononcuar mbi rastin se pistoletë në bazë të ekspertimit balistik kishte rezultuar se nuk klasifikohet si armë zjarri.

Me shkresë nr. ***, datë 11.03.2019, Komisioni i ka kërkuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan kopjen e procedimit penal lidhur me këtë ngjarje. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan me shkresën nr. *** prot., datë 15.03.2019 ka dërguar kopje të fashikullit të mosfillimit nr. *** të vitit 2012.

Nga analizimi i procedimit penal rezulton se:

Në vendimin e mosfillimit nga prokurori A. Sh., që më pas është miratuar nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit më të lartë konstatohet se në materialin referues të policisë gjyqësore pretendohet se para ndeshjes Shkumbini – Flamurtari është gjuajtur me pistoletë nga shtetasi D. S. Në vendim prokurori konstaton se arma me të cilën qëlluar është sekuestruar, por në fashikull nuk ka asnjë procesverbal sekuestrimi të provës materiale, as

vendim sekuestrimi dhe as vlerësim sekuestrimi. Arma që më pas ka rezultuar që nuk është armë zjarri është këqyrur dhe marrë në cilësinë e provës materiale dhe nuk është sekuestruar. Arma është këqyrur nga ana e oficerit të policisë gjyqësore z. A. B., dhe nuk ka dorëzues të saj.

Në raportin e shërbimit të punonjësit të policisë z. A. M., thuhet se i është dorëzuar një pistoletë në tribunën “VIP” nga shtetasi D. S., në fillimin e ndeshjes.

Në fashikull nuk pasqyrohet se si arma ka kaluar nga A. M., te OPGJ A. B., si edhe është i paqartë fakti nëse është e njëjta pistoletë.

Në raportin e vëzhguesit të FSHF-së, A. M., thuhet se një person ka ardhur dhe e ka lënë një pistoletë në dritaren e dhomave të zhveshjes, duke i thënë se nuk është armë zjarri.

Në fashikull gjenden dy deklarata me shkrim dore. Njëra nga deklaratat, ajo e datës 05.05.2012, në pjesën deklarative mbahet nga katër emra D. J., M. Q., M. D., dhe A. K., por në fund është firmosur vetëm nga M. Q., dhe D. J. Deklarata e dytë pa datë është në emër të delegatit të ndeshjes P. B.

Të dyja këto deklarata nuk përbëjnë akt, pasi nuk janë marrë në formën e kërkuar nga ligji dhe për pasojë nuk kanë asnjë vlerë provuese. Është e paqartë se si këto dy deklarata janë bërë pjesë e fashikullit.

Megjithëse ka rrethana kontradiktore mes raportit të shërbimit të punonjësve të policisë dhe raporteve të arbitrave dhe delegatëve të FSHF-së, nuk është pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethanat e hetimit shtetasi D. S., dhe as arbitrat e ndeshjes apo delegati i FSHF.

Rrethanat e paraqitura në fashikullin e mosfillimit janë të paqarta, kontradiktore dhe të mangëta.

Në K. Pr. Penale, neni 24 “Funksionet e prokurorit” (Shtuar pika “5” me ligjin nr. 8460, datë 11.2.1999 dhe me ligjin nr. 8813, datë 13.6.2002)

Pika 4 dhe 5 parashikon :

4.Urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë janë të detyrueshme për prokurorin më të ulët.

5. Prokurori më i lartë ka të drejtë të vendosë ndryshimin ose shfuqizimin e vendimeve të marra nga prokurori më i ulët me ankim ose kryesisht.

Në bazë të vendimit nr. ***, datë 29.1.2001 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ka konsideruar të paligjshëm një akt të një prokurori pranë Prokurorisë së Përgjithshme që shfuqizonte një vendim të pushimit të çështjes nga një prokuror rrethi me arsyetimin: “Të gjitha vendimet që merren gjatë fazës së hetimit paraprak, si ato për pushimin e çështjes, ashtu edhe ato për dërgimin e çështjes në gjykatë, janë vendime që merren nga titullari i organit të prokurorisë, pavarësisht nga mendimi dhe qëndrimi që mund të ketë prokurori që ndjek çështjen”.

Nga analiza konstatohet se drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, subjekti i rivlerësimit nuk ka konstatuar shkeljet procedurale dhe mangësitë në këtë hetim të paplotë, megjithëse ligji e ngarkon me këtë detyrë. Në lidhje me këtë konstatim komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit i cili pas dërgimit të rezultateve të hetimit ka sqaruar se:

*“Lidhur me kallëzimin penal nr. *** të vitit 2012 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, sipas gjetjeve të Komisionit, Drejtuesi i Prokurorisë, pra unë, nuk kam konstatuar shkeljet procedurale dhe mangësitë në një hetim të paplotë, megjithëse ligji ma ngarkon këtë detyrë. Në këtë rast, komisioni ka vlerësuar të citojë edhe vendimin nr. ***, datë 29.01.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit të gjitha vendimet që merren gjatë fazës së hetimit paraprak, si ato për pushimin e çështjes, ashtu edhe ato për dërgimin e çështjes*

në gjykatë, janë vendime që merren nga titullari i organit të prokurorisë, pavarësisht nga mendimi dhe qëndrimi që mund të ketë prokurori që ndjek çështjen, mendoj se është një referim jo i drejtë. Është e vërtetë se Drejtuesi i prokurorisë kishte mundësinë e shfuqizimit dhe ndryshimit të akteve të prokurorit më të ulët, por jo se mund të njehsohej vendimmarrja e prokurorit më të ulët me atë të eprorit. Vendimi i cituar i Gjykatës së Lartë nuk është vendim unifikues dhe si i tillë nuk mund të merret për orientim dhe as për një praktikë të konsoliduar. Pikërisht, ngaqë vendimmarrja mbi çështjen bëhej në bazë të bindjes, pas administrimit dhe analizimit të provave nga prokurori i çështjes, në rast të shfuqizimit të vendimit nga drejtuesi i prokurorisë, prokurori i çështjes kishte të drejtën e ankimit. Në rast se do të ekzistonte e kundërta, do të merrnim të mirëqenë çfarë ka shprehur Gjykata e Lartë në vendimin e mësipërm, atëherë nuk duhet të ekzistonte as e drejta e ankimit të prokurorit ndaj vendimit të shfuqizimit të drejtuesit dhe as vendimi i shfuqizimit në vetvete. Në rast se vendimmarrja e prokurorit do të konsiderohej si vendimmarrje e drejtuesit, atëherë duhet që edhe procedimet disiplinore, sipas ligjit nr. 8737 datë 12.02.2011 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" të ekzistonin vetëm për drejtuesit dhe jo për të gjithë prokurorët.

Referuar n. 24 të K.Pr.Penale, në fuqi në kohën e marrjes së vendimit të mosfillimit të sipërcituar, përcaktohet se prokurori ka të drejtë të mos fillojë ose të pushojë procedimin penal në rastet e parashikuara në këtë kod. Në rast se vendimmarrja nuk të vlerësohej e drejtë nga drejtuesi, atëherë ky i fundit kishte të drejtë të shfuqizonte dhe përsëri ndaj këtij shfuqizimi prokurori kishte të drejtën e ankimit.

Ne rastin konkret, duke iu rikthyer çështjes në diskutim, rezulton se është realizuar këqyrja e vendit të ngjarjes dhe nuk është konstatuar që të ketë pasur dëmtime mekanike apo me armë zjarri. Arma e sekuestruar, ka rezultuar që nuk ishte armë zjarri dhe si tillë mbajtja e saj nuk mund të penalizonte mbajtësin e saj. Në rastin konkret kam vlerësuar se vendimmarrja ka qenë e drejtë. Ndaj këtij vendimi nuk rezulton të jetë paraqitur ndonjë ankim."

Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë bindëse dhe nuk mbështeten në prova. Në këtë procedim nga ana e tij në cilësinë e drejtuesit të organit të akuzës duhej të konstatoheshin mangësitë në këtë procedim dhe t'i kërkohej prokurorit të çështjes plotësimi i tyre. Në përfundim Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit sërish ka shfaqur njohuri e aftësi të cekëta dhe gjykim të dobët për kryerjen e procedurave dhe veprimeve të nevojshme hetimore, me qëllim vendosjen përpara drejtësisë të personave që kanë kryer vepra penale si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij si drejtues i Prokurorisë, të cilat konsiderohen mangësi profesionale.

4. Në lidhje me trajtimin e denoncimit të shtetases D. M.

Nga ana e trupit gjykues, më datë 17.06.2019, është administruar denoncimi i shtetases D. M., ardhur me email më datë 15.06.2019, e cila pretendon se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë Elbasan ka favorizuar shtetas të ndryshëm, duke ndikuar të prokurorët e çështjes për caktimin e masave të sigurimit personal të buta, për kërkimin e dënimit me masa të ulta, për mosankimimin e vendimeve të gjykatave të shkallës së parë kur ato kishin vendosur ndryshe nga sa kishte kërkuar Prokuroria. Në denoncimin e saj denoncuesja listonte dhe procedimet përkatëse.

Nga ana e Komisionit menjëherë iu dërgua shkresa nr. *** prot., datë 19.06.2019, Prokurorisë Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan duke i kërkuar dosjet e përmendura në denoncim. Prokuroria na vuri në dispozicion dosjet përkatëse me shkresat nr. *** prot., datë 26.06.2019;

nr. *** prot., datë 25.06.2019; nr. *** prot., datë 27.06.2019; nr. *** prot., datë 28.06.2019; nr. *** prot., datë 25.06.2019.

Komisioni i shqyrtoi hollësisht të gjitha dosjet e administruara, i kërkoi shpjegime subjektit, dhe pasi i shqyrtoi këto, në përfundim ka konkluduar me gjetjet e mëposhtme:

- a. Denoncuesi pretendonte se:** *Në vitet 2010 e 2011 i dënuari E. M., është përgjuar nga policia gjyqësore për veprat penale të trafikimit të drogës dhe prostitucionit. Nga përgjimet e tij ka dalë se gjyqtari Z. Sh., i ka kërkuar të dënuarit E., t'i siguronte kushte për afëra seksuale nga Z., me vajza të ndryshme. Prokurori Rrethit në këto vite i quajtur Elvin Gokaj ka dijeni për këto përgjime. Me qëllime shantazhimit ndaj Z., dhe Z., ishte në dhomën penale e për interesa pasurore e procedurale të Elvinit, ky prokuror rrethi nuk bëri veprime procedurale kundra Z. Në çdo rast Z., përkrahte veprimet e ndërhyrjet e Prokurorit Elvin Gokaj për lirime para kohe me kusht e për çështje të tjera ose i lironte Z., (me ndërhyrjen e Elvinit) të dënuarit para kohe me kusht dhe prokuroria nuk bënte ankim .*

Nga analiza e fashikullit penal, rezulton se:

- Ka patur përgjime të bisedave telefonike te shtetasit E. M., me disa shtetas të tjerë;
- Në këto përgjime përmendet nga E. M., edhe prania e një shtetasi të quajtur Z., të cilit ai i referohet si “ai gjyqtari i mirë”;
- Nuk rezulton asnjë veprim procedural hetimor për identifikimin e shtetasit Z., apo personit që i referohet shtetasi E. M., si “ai gjyqtari i mirë”.

Nga analiza konstatohet se, subjekti i rivlerësimit nuk ka konstatuar mangësitë në këtë procedim penal, megjithëse ligji dhe aktet nënligjore⁶ e ngarkojnë me këtë detyrë, si dhe nga ana e tij duket se është favorizuar gjyqtari i përmendur, për sa kohë nga ana e Prokurorisë Elbasan nuk është filluar kryesisht procedimi penal dhe nuk është bërë asnjë hetim në lidhje me shtetasin e quajtur Z.

Në lidhje me këtë konstatim Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit, i cili pas dërgimit të rezultateve të hetimit ka sqaruar se:

*“Gjatë kryerjes së veprimeve hetimore të këtij procedimi penal është evidentuar se ka patur përgjime të bisedave telefonike te shtetasit E.M. me disa shtetas të tjerë. Në këto përgjime përmendet nga E.M. edhe prania e një shtetasi të quajtur Z., i cili është identifikuar si gjyqtari Z.Sh. Ju bëj me dije se nga ana ime nuk ka pasur asnjë favorizim për këtë gjyqtar, pasi sapo jam vënë në dijeni me përgjimet i kam referuar materialet përkatëse tek Prokurori i Përgjithshëm, si organ kompetent përderisa gjyqtari kryente funksionet në Gjykatën e Elbasanit. Këtë gjë e provoj me shkresën nr. *** datë 19.03.2012 drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm. Referuar legjislationit të asaj kohe, kam pasur mundësi vetëm t'i referoja materialet përkatëse prokurorit më të lartë, ku i kam kërkuar të merren masa që do të shihen të nevojshme në kuadrin e marrëdhënies ndërinstitucionale.”*

Subjekti ka bashkëlidhur shkresën nr. ***, datë 19.03.2012 drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm. Në këtë shkresë subjekti i rivlerësimi informon Prokurorin e Përgjithshëm në lidhje me z. Z. Sh., dhe rezultatet e përgjimit, duke kërkuar që të merren masat që do të shihen të nevojshme në kuadrin e marrëdhënieve ndërinstitucionale.

⁶ Urdhër nr.*** datë 09.05.2008 dhe urdhër nr.***, datë 09.05.2008, i Prokurorit të Përgjithshëm

Komisioni vlerëson se subjekti ka paraqitur prova bindëse për të vërtetuar se nga ana e tij nuk është favorizuar z. Z. Sh., po nga ana tjetër ai bazuar në Kodin e Procedurës Penale duhej menjëherë të kishte filluar procedimin penal, duke qenë se nuk ishim në kushtet e parashikuara nga neni 290 i K. Pr. Penale dhe më pas të vijonte me veprimet e tjera të nevojshme institucionale. Në përfundim Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur njohuri, aftësi të cekëta si dhe gjykim të dobët për kryerjen e procedurave dhe veprimeve të nevojshme hetimore, me qëllim vendosjen përpara drejtësisë të personave që kanë kryer vepra penale, të cilat konsiderohen mangësi profesionale.

b. Në lidhje me çështjen penale me të pandehur L. K. (T.) denoncuesi pretendon se: *“Ky i pandehur ishte me precedent penal, i dënuar me parë , hetuar me masë sigurimi arrest në burg në mungesë, akuzuar për 4 vepra penale në fushën e rendit e sigurisë publike. Prokurori i seancës (me ndërhyrjen e Prokurorit të Rrethit Elvin Gokaj) kërkon dënim me gjobë. Edhe Gjykata Elbasan e dënon L., me gjobë, me vendimin penal numër ***, datë 03-10-2008. Prokurori i Rrethit Elvin Gokaj, nuk ndërhyr për të bërë ankim në Apel, për t’u dënuar L., me burgim.”*

Pas administrimit të dosjes, rezultoi se:

- Bazuar në diskutimet përfundimtare të prokurorit të çështjes (në të cilën analizohet rrezikshmëria shoqërore e veprës penale, shkalla e fajësisë, mekanizmin i ngjarjes, mjetet dhe mënyrat që ka përdorur për kryerjen e veprës penale i pandehuri), lloji i dënimit i kërkuar (me gjobë) për të pandehurin, nuk përputhet me argumentet e dhëna në pjesën arsyetuese si dhe me provat e administruara.
- Në kuadër të organizimit të punës në prokuroritë e rretheve, qëndrimi përfundimtar që mban institucioni i akuzës, që në çështjen konkrete përfaqësohej nga prokurori përkatës, duhej t’i nënshtrohej diskutimit me drejtuesin e saj, nga ky diskutim do të përcaktohej edhe lloji dhe masa e dënimit që do të kërkohej konkretisht. Pra, arsyetimi i qëndrimit përfundimtar duhej të përgatitej nga prokurori i çështjes, ndërsa lloji dhe masa e dënimit janë produkt i diskutimit me drejtuesin e prokurorisë. Në rastin konkret, lloji i dënimit i kërkuar për të pandehurin, nuk përputhet me argumentet e dhëna në pjesën arsyetuese të dokumentit.

Për sa më sipër rezulton se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë nuk ka konstatuar mospërputhjet midis pjesës arsyetuese të diskutimeve përfundimtare të Prokurorit të çështjes me llojin e dënimit të kërkuar. Në lidhje me këtë konstatim, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit, i cili pas dërgimit të rezultateve të hetimit ka sqaruar se:

“Ngjarja në fjalë, shkak për regjistrimin e procedimit penal, ka pasur të bëjë me një person që nën efektin e pijeve alkoolike, pasi ka pirë disa gota birrë, ka nxjerrë një pistoletë nga brezi dhe ka filluar të shajë brenda ambienteve të lokalit ku qëndronte ulur. Ai ka kanosur kamarierin dhe banakierin nën pretendimin përse nuk i jepnin për të pirë një personi (dëshmitarit B.B.). Viktimat kanë dëshmuar se nuk e njihnin të pandehurin dhe në seancë kanë deklaruar se nuk kanë ankim për veprimet e të pandehurit për shkak të njohjes pas ngjarjes, me familjarët e të pandehurit.

Neni 278/2 i kohës parashikonte dënimin me gjobë ose me burgim deri në shtatë vjet.

Neni 274 dhe neni 84i K.Penal përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen respektivisht me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet dhe me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Prokurori ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese normalizimin e marrëdhënieve, ka vlerësuar faktin se i pandehuri është invalid i grupit të parë dhe për shëndetin e tij është e dosmosdoshme asistenca e familjarit.

Gjendur në këto kushte, kemi vlerësuar se masa e dënimit e kërkuar, i shërbente shoqërisë. Më mirë pagesa e një shume prej 600 000 lekë sesa burgosja dhe shpenzimet për mbajtjen e të pandehurit në burg. Burgimi nuk është gjithmonë dënimi më i drejtë. Në rastet kur vlerësohet se mund të arrihet riedukimi dhe ndëshkimi me një masë tjetër, atëherë mund të jepet një dënim i ndryshëm nga burgimi.

Ngjarja e ndodhur nuk rezultoi të ishte si pasojë e ndonjë konflikti të mëparshëm. Ka qenë vetëm për shkak të gjendjes së dehur të të pandehurit.

Për më tepër, referuar nenit 378 të K.Pr.Penale prokurori formulon dhe parashtron konkluzionet. Pra, kërkimi i llojit dhe masës së dënimit nuk ka qenë detyrues për prokurorin, megjithë praktikën e mbajtur.

Gjithashtu individualizimi i dënimit është detyrë e gjykatës dhe jo e prokurorit. Referuar nenit 47 të K.Penal, Gjykata cakton dënimin, duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij Kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit, ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Në relacionin e Komisionit nuk ka asnjë të dhënë se përse në rastin konkret, lloji i dënimit i kërkuar për të pandehurin, nuk përputhet me argumentet e dhëna në pjesën arsyetuese të dokumentit. Kemi pasur të bëjme me konsumimin e dy kundërvajtjeve penale dhe të një krimi, ku ky i fundit, mund të dënohej edhe me gjobë.

I pandehuri L.K. (T.) ka rezultuar se ka qenë paraplegjik sipas librezës për përfituesin e statusit të invalidit.”

Subjekti ka bashkëlidhur:

- Diskutimet përfundimtare të prokurorit të çështjes;
- Vendimin e gjykatës për dënimin e të pandehurit L. K.;
- Shkresë nr. *** prot., datë 09.08.2008 të Bashkisë Elbasan në të cilën jepet informacion në lidhje me z. L. K.;
- Librezë invaliditeti e z. L. T.

Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse pasi në dokumentin konkluzione përfundimtare parashtrahet si më poshtë:

“Veprat e kryer nga i pandehuri paraqet rrezikshëmri të theksuar shoqërore...

Rrezikshmëri paraqet dhe vetë i pandehuri që ka kryer këto vepra ...

I pandehuri pas caktimit të masës së sigurimit arrest në burg i është shangur hetimit dhe gjykimit.”

Për sa më sipër rezulton se subjekti i rivlerësit nuk ka konstatuar mospërputhjen midis pjesës arsyetuese të diskutimeve përfundimtare të prokurorit të çështjes me llojin e dënimit të kërkuar, duke treguar njohuri të cekëta dhe gjykim të dobët në lidhje me analizimin e llojit të dënimit të kërkuar si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij si drejtues i Prokurorisë, të cilat konsiderohen mangësi profesionale.

- c. Në këtë denoncim, shtetasja denoncuese pretendon për ndikim të subjektit të rivlerësimit tek prokurorë të ndryshëm, për favorizim të shtetasit të proceduar disa herë, S. S.

i. Në lidhje me çështjen penale të vitit 2008, me të pandehur S. S., për akuzën sipas nenit 236 të Kodit penal **denoncuesi pretendon se**: *“Prokurori i seancës (me ndërhyrjen e Prokurorit të Rrethit Elvin Gokaj) kërkoi që S., të dënohej me gjobë, megjithëse S., akuzohej për bashkëpunim dhe ishte i dënuar më parë (sipas vendimit penal numër ***, datë 04-6-2008 të gjykatës Elbasan). Edhe Gjykata Elbasan e dënon me gjobë S., me vendimin penal numër *** datë 01-7-2008. Prokurori i Rrethit Elvin Gokaj nuk ndërhyr për të bërë ankim në Apel, për t’u dënuar S., me burgim.”*

Nga shqyrtimi dhe analizimi i fashikullit penal, rezulton se:

Prokurori i çështjes e arsyeton kërkesën e tij për dënimin me gjobë të pandehurit bazuar në rrezikshmërinë e veprës penale, qëndrimin e thellë pendues të pandehurve, si dhe faktin që S. S., është provokuar nga punonjësit e policisë.

Të gjitha rrethanat e përmendura nga prokurori për caktimin e dënimit me gjobë nuk mbështeten në provat e administruara, sepse:

- Shtetasi S. S., gjatë kohës që ishte në hetim ka kryer të njëjtën vepër penale për të cilën ishte në hetim;
- Nuk rezulton që i pandehuri të jetë provokuar nga ana e forcave të rendit;
- Nuk rezulton që ai të ketë shfaqur pendim të thellë.

Në kuadër të organizimit të punës në prokuroritë e rretheve, qëndrimi përfundimtar që mban institucioni i akuzës, që në çështjen konkrete përfaqësohej nga prokurori përkatës, duhej t’i nënshtruhej diskutimit me drejtuesin e saj, nga ky diskutim do të përcaktohej edhe lloji dhe masa e dënimit që do të kërkohej konkretisht. Pra, arsyetimi i qëndrimit përfundimtar duhej të përgatitej nga prokurori i çështjes, ndërsa lloji dhe masa e dënimit janë produkt i diskutimit me drejtuesin e prokurorisë. Në rastin konkret, arsyetimi i prokurorit për caktimin e llojit të dënimit nuk është i mbështetur në prova. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë nuk ka konstatuar mospërputhjet midis provave të administruara dhe parashtrimeve të prokurorit të çështjes në lidhje me kërkesën për llojin e dënimit të kërkuar për shtetasin S.S.

Në lidhje me këtë konstatim, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektivit, i cili, pas dërgimit të rezultateve të hetimit ka sqaruar se:

*“Në procesverbalin e datës 02.06.2008 nga ana e të pandehurit S.S. janë ngritur ndër të tjera pretendime se punonjësit e policisë e kanë shoqëruar në mënyrë të paligjshme dhe i kanë shkaktuar dëmtime. Nga vërtetimi i gjendjes gjyqësore nr. *** prot datë 21.04.2008 shtetasi S.S. rezulton i padënuar. Prokurori i çështjes në diskutimin përfundimtar ka kërkuar deklarinimin fajtor të të pandehurit S. S., për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 236/2 i K.Penal dhe dënimin e tij me 510, 000 lekë gjobë.*

Diskutimi përfundimtar i përgatitur nga prokurori i çështjes B.N. nuk mban nënshkrimin tim. Gjendur në këto kushte nuk mund të aludohet se nga ana ime është dhënë mendim mbi masën e dënimit të kërkuar nga prokurori apo se nga ana ime në ndonjë mënyrë është favorizuar i pandehuri. Për shkak të volumit të madh të punës, pavarësisë së prokurorit në seancë gjyqësore, mund të ndodhte që konkluzionet të jepeshin edhe pa u arritur të diskutohej me Drejtuesin e Prokurorisë.

Vërtet vepra penale e kundërshtimit të punonjësit të policisë së rendit publik, parashikon dënim me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet. Pra, në rastin konkret, marzhi i dënimit i mundëson gjykatës të arsyetojë mbi individualizimin e dënimit.

Për më tepër, referuar nenit 378 të K.Pr.Penale prokurori formulon dhe parashtron konkluzionet. Pra, kërkimi i llojit dhe masës së dënimit nuk ka qenë detyrues për prokurorin, megjithë praktikën e mbajtur.

Gjithashtu individualizimi i dënimit është detyrë e gjykatës dhe jo e prokurorit.”

Subjekti pavarësisht deklarimeve të tij pranon që konkluzionet diskutoheshin me drejtuesin e prokurorisë. Në rastin konkret, argumentet e tij nuk janë bindës, pasi ai deklaroi se diskutimi përfundimtar nuk mban nënshkrimin e tij, por ky fakt nuk e përjashton atë nga detyrimi që kishte për të diskutuar për konkluzionet përfundimtare për çdo çështje të dërguar në gjykatë si një detyrim ligjor. Subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë asnjë shpjegim në lidhje me konstatimet e Komisionit për sa i përket faktit se rrethanat e përmendura nga prokurori nuk përputhen me provat e administruara.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka konstatuar mospërputhjen midis provave të administruara me llojin e dënimit të kërkuar, duke treguar njohuri të cekëta dhe gjykim të dobët në lidhje me analizimin e provave dhe analizimin e llojit të dënimit si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij si drejtues i Prokurorisë, të cilat konsiderohen mangësi profesionale.

ii. Në lidhje me çështjen penale të vitit 2010, me të pandehur S. S., për akuzën sipas nenit 89 dhe 278/2 të Kodit Penal denoncuesit pretendon: *Prokurori i seancës (me ndërhyrjen e Prokurorit të Rrethit Elvin Gokaj) kërkoj që S., të dënohej me masë të butë dënimi me burgim (megjithëse S., akuzohej për dy vepra të rënda dhe ishte i dënuar më parë sipas vendimeve penale numër *** datë 04-6-2008 dhe numër *** datë 01-7-2008 të gjykatës Elbasan). Edhe Gjykata Elbasan e dënon S. (me 5 muaj burgim) me vendimin penal datë 29-6-2010, por nuk u përcaktua nga gjykata kur i fillonte S., vuajtja e dënimit. Prokurori i Rrethit Elvin Gokaj nuk ndërhyr për të bërë ankim në Apel, për t'u dënuar S., me masë të rëndë dënimi me burgim dhe për t'u ndrequr koha se kur i fillonte Sokolit vuajtja e dënimit.”*

Nga analiza e fashikullit, rezulton se:

- Shtetasi S., ka qëlluar tri herë në drejtim të dëmtuarit dhe ky moment nuk rezulton të jetë i analizuar nga prokurori nëse kishim të bënim me veprën penale të vrasjes së mbetur në tentativë apo plagosjes.
- Në datë 01.06.2010 është marrë vendim nga organi i Prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjyq të procedimit penal nr. ***/2010. Në këtë vendim rezulton që akuza është e ndryshme nga ajo e regjistrimit të procedimit, pasi nga plagosje e rëndë është bërë plagosje e lehtë me dashje. Në dosje nuk ka një vendim prokurori për ndryshimin e cilësimit të veprës penale.
- Është e paqartë se ku është bazuar prokurori për të deklaruar se z. S., është i padënuar si dhe marrëdhëniet mes të pandehurit dhe viktimës janë normalizuar për të kërkuar një masë dënimi të ulët. Ajo që konstatohet është se masa e dënimit e kërkuar nga organi i prokurorisë është në dënimin minimal të parashikuar nga Kodi për këto vepra penale.

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë nuk ka konstatuar mangësitë në këtë procedim penal, megjithëse ligji dhe aktet nënligjore⁷ e ngarkojnë me këtë detyrë.

⁷ Urdhër nr *** datë 09.05.2008 dhe Urdhër nr.*** datë 09.05.2008 i Prokurorit të Përgjithshëm

Në lidhje me këtë konstatim, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit, i cili, pas dërgimit të rezultateve të hetimit ka sqaruar se:

*“Sipas aktit të ekspertimit nr. ***, datë 14.04.2010 ka rezultuar se dëmtimet e shtetasit E.D., janë plagë në këmbën e majtë, thyerje e katër gishtave të këmbës së majtë, të shkatuara me armë zjarri, dhe hyjnë në kategorinë e atyre dëmtimeve që kanë shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se 9 ditë. Në deklaratimet e datës 09.04.2010 dhe 13.04.2010, shtetasi E.D. ka deklaruar se nuk ka pasur ndonjë konflikt me shtetasin S. S.*

Në lidhje me këtë çështje sqarohet se nga ana e prokurorit të çështjes, është pasqyruar në kërkesën për gjykim fakti i ndodhur. Vetë fakti që i dëmtuari është plagosur në këmbë, ka qenë në një distancë shumë të afërt me autorin, tregon se ndodhemi para veprës penale të plagosjes dhe jo vrasjes së mbetur në tentativë. Nëse i pandehuri do të kishte për qëllim ta vriste të dëmtuarin, ka pasur të gjitha mundësitë për ta bërë atë.”

Argumentimi i bërë nga subjekti i rivlerësimit në këtë paragraf nuk gjendet në konkluzionet e prokurorit është pikërisht ky argumentim, i cili është konstatuar nga Komisioni që mungon.

Subjekti shpjegon më tej: *“Në lidhje me ndryshimin e cilësimit të veprës penale, ju bëj me dije se në bazë të dispozitave procedurale penale të kohës kur ka ndodhur ngjarja, cilësimi përfundimtar bëhet në aktin për njoftimin e akuzës dhe marrjen e personit si të pandehur. Ndërkohë vetëm me ndryshimet e vitit 2017 në nenin 287 të K.Pr.Penale, u parashikua që për këtë ndryshim të urdhërohet me një akt të veçantë, i cili duhet të regjistrohet në regjistrat e njoftimit të veprës penale. Pra, kjo gjetje e Komisionit nuk është e mbështetur në ligj. Nga gjykata është vlerësuar se cilësimi juridik i veprave ka qenë i saktë. Në lidhje me masën e dënimit, sjellim në vëmendje se plagosja e lehtë është kundërvajtje penale, vepra penale e armëmbajtjes ka pasë parashikuar edhe dënimin me gjobë. Nuk është i drejtë arsyetimi i komisionit se dënimi i kërkuar është minimal, pasi dënimi minimal me burg ka qenë pesë ditë sipas ligjit penal. Prokurori ka kërkuar dënimin me 6 muaj burgim të të pandehurit.*

Akti konkluzion i diskutimit përfundimtar datë 29.06.2010 i përgatitur nga prokurori M.L. nuk rezulton të jetë nënshkruar prej meje, gjë që nuk ka si të provojë faktin se nga ana ime është kryer ndonjë veprim për të favorizuar të pandehurin.

Për më tepër, referuar nenit 378 të K.Pr.Penale prokurori formulon dhe parashtron konkluzionet. Pra, kërkimi i llojit dhe masës së dënimit nuk ka qenë detyrues për prokurorin, megjithë praktikën e mbajtur.

Gjithashtu individualizimi i dënimit është detyrë e gjykatës dhe jo e prokurorit.”

Komisioni vlerëson se argumentat e subjektit të rivlerësimit nuk janë bindës, pasi ai deklaroi se diskutimi përfundimtar nuk mban nënshkrimin e tij, por ky fakt nuk e përjashton atë nga detyrimi që kishte për të diskutuar për konkluzionet përfundimtare për çdo çështje të dërguar në gjykatë si një detyrim ligjor. Subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë asnjë shpjegim se ku është bazuar prokurori për të deklaruar se z. S., është i padënuar si dhe marrëdhëniet mes të pandehur dhe viktimës janë normalizuar për të kërkuar një masë dënimi të ulët. Ndërkohë siç rezulton dhe më lart shtetasi S., ka qenë një person, i cili është dënuar disa herë.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë nuk ka konstatuar mangësitë në këtë procedim penal, duke treguar njohuri dhe aftësi të cekëta, gjykim të dobët për të analizuar provat e administruara si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij si drejtues i Prokurorisë, të cilat konsiderohen mangësi profesionale.

d. Në lidhje me ngjarjen e datës 07-4-2008 më të pandehur E. B., dhe R. K., të akuzuar për mbajtje e shpërndarje droge në shkollë denoncuesi pretendon: Prokurori i seancës

(me ndërhyrjen e Prokurorit të Rrethit Elvin Gokaj) kërkoi nga gjykata të caktohet masa e sigurimit detyrim paraqitje, kur kjo vepër akuzohej në bashkëpunim dhe kishte rrezikshmëri të veçantë të dy të pandehurit se u kapën për shpërndarje droge në shkollë. Prokurori i Rrethit Elvin Gokaj, nuk ndërhyr për të kërkuar në gjykatë masë paraburgimi ose për të bërë ankim në Apel.

Nga fashikulli i procedimit penal rezulton se:

- Nga ana e Prokurores E. T., është kërkuar caktimi i masës së sigurimit personal “Detyrim paraqitje” për shtetasin E. B., dhe R. K., për të cilët dyshohej për kryerjen e veprës penale të prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike.
- Nga analizimi i dosjes kërkesa e Prokurorisë për caktimin e masës së sigurimit detyrim paraqitje nuk është e argumentuar, duke marrë në konsideratë faktin se të dy këto shtetas ishin arrestuar në flagrancë me lëndë narkotike, si dhe kishte dyshime të arsyeshme për kryerjen e veprës penale të “prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike”.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë nuk ka konstatuar se kërkesa e prokurorit të çështjes për caktimin e masës së sigurimit personal “detyrim paraqitje” nuk ishte e argumentuar.

Në lidhje me këtë konstatim, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit, i cili, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, ka sqaruar se:

“Lënda narkotike që i është kapur shtetasit E.B. ka qenë vetëm 0.7 gramë, canabis sattiva, pra, e një sasive shumë të vogël. Madje pas peshimit nga ekspertët, kjo lëndë ka rezultuar në 0.5 gram. Ekzistonte ndërkohë dyshimi se ky shtetas mund të ishte përdorues i lëndës narkotike. Në këto momente prokurori i çështjes vlerëson mbi provat e momentit dhe arsyeton mbi të dhënat që mund të ketë mbi to. I njëjti arsyetim qëndron edhe për shtetasin R.K., i cili nuk rezulton të jetë paguar për sasinë që i ka dhënë shtetasit E.B. dhe se edhe ai vetë mund të ishte përdorues i kësaj lënde.

Të dy këta të pandehur rezultuan në moshë të re. Neni 230 i K.Pr.Penale në caktimin e kriterëve për caktimin e masës së sigurimit së arrestit në burg, përcakton se arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit. Nuk mundet thjesht të thuhet se kërkesa është e paargumentuar. Kërkesa për caktim mase është bërë mbështetur mbi provat e administruara deri në atë moment dhe nuk ka pasur të dhëna mbi ndonjë veprimtari kriminale të këtyre shtetasve që të legjitimohej kërkimi i një caktimi mase sigurimi më të rëndë.”

Komisioni pasi analizoi përgjigjen e subjektit vlerëson se ajo nuk është bindëse. Në kërkesën për masën e sigurimit parashikohet se:

“Nga veprimet e para hetimore të kryera ka dyshime se shtetasit R. K., dhe E. B., kanë bashkëpunuar edhe me persona të tjerë në shpërndarjes e bimës narkotike...”

Ka dyshime të arsyeshme të mbështetur në prova që shtetasi E. B., mund të ketë kryer veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike në bashkëpunim...”

Mbështetur në kërkesën për masë sigurimi si dhe provat e administruara, rezulton se masa e sigurimit detyrim paraqitje nuk është e argumentuar, pasi nga analizimi i provave të administruara rezulton se nuk plotësohen kriteret e parashikuar nga neni 229 dhe 230 i K.Pr. Penale.

Në përfundim, Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë duhej të kishte konstatuar mungesën e argumentimit të prokurorit të çështjes, duke treguar njohuri të cekëta dhe gjykim të dobët në analizimin e provave dhe argumentimin e masës së sigurimit konform neneve 229-230 të K.Pr. Penale si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij si drejtues i Prokurorisë, të cilat konsiderohen mangësi profesionale.

e. Në lidhje me të pandehurin F. K., i akuzuar për mbajtje droge në bashkëpunim, denoncuesi pretendon: *Prokurori i çështjes (me ndërhyrjen e Prokurorit të Rrethit Elvin Gokaj) i ndryshoi akuzën gjatë hetimit dhe e akuzoi për moskallëzim krimi. Prokurori i Rrethit Elvin Gokaj, nuk ndërhyr për ta ndryshuar akuzën, që ta akuzojë për drogë.”*

Nga analiza e dokumentacionit përbërës të fashikullit penal rezulton se:

- Shtetasit F. K., dhe shtetasit A. T., i janë sekuestruar celularët, por nga ana e prokurorisë nuk rezulton të jetë kryer veprimi procedural i kqyrjes të telefonave të sekuestruar;
- Nga ana e organit të Prokurorisë nuk janë administruar tabulatet telefonike të personave në hetim për të për të provuar njohjet midis personave nën hetim si dhe komunikimet e mundshme telefonike midis tyre në funksion të çështjes;
- Nga ana e organit të akuzës nuk është kryer asnjë veprim hetimor në lidhje me deklaratimet e F. K., se ai ka qenë taksist dhe ditën e ngjarjes dhe ka qenë në varrimin e mbesës së shtetasit A. T., në Tiranë;
- Në datë 26.06.2008 pa u kryer asnjë veprim hetimor shtesë është vendosur ndryshimi i akuzës për z. F. K., nga vepra penale e “Prodhimit dhe shitjeve të narkotikëve” në veprën penale të “Moskallëzimit të krimit”.

Komisioni konstaton se drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, subjekti i rivlerësimit, nuk ka konstatuar mangësitë në këtë hetim të paplotë, megjithëse ligji dhe aktet nënligjore⁸ e ngarkojnë me këtë detyrë. Në lidhje me këtë konstatim, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit, i cili, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, ka sqaruar se:

“Është proceduar me këqyrjen e telefonit të shtetasit E.D. që në fakt rezultoi se numri i telefonit i përket shtetasit A.T. Ky fakt është pasqyruar në procesverbalin e datës 02.02.2008. Nga aktet toksikologjike rezultoi se shtetasit F.K., A.T. dhe E.D. ishin përdorues të lëndës narkotike.

Janë kryer veprime të mëtejshme hetimore, si është administruar deklarimi i shtetasit E.D. datë 02.02.2008, 04.02.2008 dhe 03.04.2008, i cili ka pohuar se ditën e ngjarjes është telefonuar nga shtetasi A.T. dhe së bashku me shtetasin F.K., janë nisur për në Elbasan, me mjetin e shtetasit F.K. Kur i ka dalë policia para ka qenë shtetasi A.T. i cili i ka dhënë qesen që ka qenë në sediljen e parë të makinës. I pandehuri F.K. i ka bërë titur duke i thënë “ik zhduku, çfarë pret, zhduku bashkë me qesen”.

Gjithashtu është proceduar edhe me përdorimin e metodave speciale të hetimit, konkretisht të përgjimit ambiental.

⁸ Urdhër nr.***, datë 09.05.2008 dhe urdhër nr.***, datë 09.05.2008 i Prokurorit të Përgjithshëm.

Pas kryerjes së veprimeve hetimore, me vendimin datë 26.06.2008, prokurori ka vendosur ndryshimin e akuzës për shtetasin F.K. duke e akuzuar nga kryerja e veprës penale parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal në atë të parashikuar nga neni 300 i K.Penal.

Nga provat e administruara, prokurori ka vlerësuar se nuk implikohej shtetasi F.K. në lidhje me ngjarjen në fjalë, për sa i përket mbajtjes së lëndës narkotike.

Ky ka qenë gjithashtu edhe një vlerësim i OPGJ-së që ka hetuar çështjen.

Në këto kushte është vlerësuar ndryshimi i akuzës nga “Prodhim dhe shitje e narkotikëve” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale në atë të “Moskallzimit të krimit”, parashikuar nga neni 300 i K.Penal.

Është atribut i prokurorit vlerësimi i provave. Nuk ka asnjë person të pagabueshëm në punën e tij dhe për këtë shkak mund të jetë e mundur që secili të bëjë edhe një vlerësim jo të drejtë të provave, por pikërisht për këtë shkak prokurori nuk njihet si institucion që jep drejtësi, por është gjykata ajo që e bën një gjë të tillë.

Procesi i çmuarjes së provave është një proces kompleks dhe i vështirë. Për këtë shkak siç theksova më lart nuk i është lënë në dorë prokurorit të vendosë drejtësi dhe për këtë shkak edhe sistemi gjyqësor është i organizuar dhe funksionon me shkallë, me qëllim zbulimin e së vërtetës objektive mbështetur mbi prova. Nga gjykatat nuk është parashtruar se ka mungesë provash, por është analizuar mbi cilësimin ligjor mbështetur në provat e administruara. Në rast se do të kishim mungesë provash, në respektim të nenit 367 të K.Pr.Penale, gjykata edhe kryesisht mund të procedonte me marrje provash të reja.

Përsa më sipër, kam vlerësuar se mbështetur në aktet e administruara cilësimi ligjor i veprës penale ka qenë i drejtë. Asnjë e dhënë, indicie apo provë nuk ekziston në lidhje me personin tim që të kem influencuar për të favorizuar të pandehurin.

E gjej të padrejtë gjithashtu faktin se unë si drejtues Prokurorie të ngarkohem me përgjegjësi për çdo veprim të kryer nga secili prokuror në Prokurorinë e Elbasanit. Prokurori është entitet më vete dhe nuk mund të trajtohen si nëpunës të mi, ku secili akt apo veprim i kryer prej tyre, duhet të më ngarkojë mua me përgjegjësi penale. Ligji nr. 8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, kreu VII, neni 28 e në vijim, sanksionon nëpërmjet dispozitave procedurën dhe shkaqet e procedimit disiplinor. Nuk është parashikuar në këto dispozita se Drejtuesi i Prokurorisë mban përgjegjësi disiplinore në çdo rast kur konstatohet shkelje nga ana e prokurorëve.”

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, bazuar në nenin 24 dhe 25 të K.Pr. Penale, si dhe pikën 2, 2.1 dhe 3 të urdhrit nr. *** datë 09.05.2009 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në Prokurorinë e Shkallës së Parë” ku parashikohet se:

“Vendimi i mosfillimit të procedimit, vendimi i pushimit të akuzës ose çështjes, vendimi i pezullimit të hetimit, kërkesa për caktimin e masave të sigurimit dhe kërkesat për revokim dhe/ose ndryshimin e tyre kërkesat e tjera që i drejtohen gjykatës, vendimi i afatit të zgjatjes së hetimeve, kërkesa për gjykimin e çëshjtes, konkluzionet përfundimtare si dhe urdhërat në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, mbështetur në kërkesat e ligjit procedural penal formulohen, arsyetohen dhe nënshkruhen nga prokurori i çështjes.

Prokurori i çështjes duhet të dikutojë paraprakisht me drejtuesin e prokurorisë, kërkesat për caktimin e masave të sigurimit, kërkesat për revokimin dhe/ose ndryshimin e tyre, vendimin për zgjatjen e afateve të hetimive dhe kërkesat për zgjatjen e paraburgimit, si dhe kërkimet në konkluzionet përfundimtare për deklarimin e fajësisë dhe caktimin e llojit dhe masës së dënimit, me synim për të tarandaluar pasojat që mund të shkaktojnë vendimarrja e pabazuar në ligj dhe në prova. Për këto akte, kur bie dakord, drejtuesi vendos në thembër të aktit nënshkrimin e tij, kopje e cila vendoset në fashikullin e prokurorit.

Drejtuesit e prokurorive të shkallës së parë, para se të nënshkruajnë shkresat për kalimin e akteve të prokuroritë në gjykatë ose tek subjektet e tjerë të procedimit penal, para se të vendoset arkivimi i fashikujve të procedimeve penale të mosfilluara ose të përfunduara, si dhe para se të vendoset arkivimi i praktikave që ata kanë në ndjekje kanë për detyrë të kontrollojnë bazueshmërinë në ligj të akteve dhe të procedimit penal. Ata marrin përgjegjësi për kontrollin e zgjidhjes ligjore dhe/ose formulimin e aktit nga prokurori më i ulët.

Megjithëse kishte detyrimin ligjor që të konstatonte moskryerjen e veprimeve hetimore nga ana e prokurorit të çështjes, që kishin lidhje të drejtpërdrejtë me rolin e z. F. K., në këtë procedim penal, subjekti nuk jep asnjë argument në lidhje me moskryerjen e veprimeve hetimore të mëposhtme:

- Moskryerjen e këqyrjes së telefonave të sekuestruar z. F. K., dhe z. A. T.;
- Mosadministrimin e tabulateve telefonike të personave në hetim për të provuar njohjet midis personave nën hetim si dhe komunikimet e mundshme telefonike midis tyre në funksion të çështjes;
- Moskryerjen e asnjë veprimi hetimor në lidhje me deklaratimet e z. F. K., se ai ka qenë taksist dhe ditën e ngjarjes dhe ka qenë në varrimin e mbesës së shtetasit A. T., në Tiranë.

Nga ana e tij nuk sqarohet se cilat kanë qenë arsyet që pa u kryer asnjë veprim hetimor shtesë është vendosur ndryshimi i akuzës për z. F. K., nga vepra penale e “Prodhimit dhe shitjeve të narkotikëve në veprën penale të “Moskallëzimit të krimit”. Moskryerja e këtyre veprimeve hetimore, për sa kohë nuk është arritur të provohet se është bërë me qëllim favorizimin e z. F. K., nga subjekti i rivlerësimit, tregojnë njohuri e aftësi të cekëta dhe gjykim të dobët për të hetuar si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij si drejtues i Prokurorisë, të cilat konsiderohen mangësi profesionale.

f. Në lidhje me ngjarjen e vitit 2012 me të pandehur E. D., dhe R. T., të akuzuar për mbajtje e shpërndarje droge denoncuesi pretendon: “Prokurori i seancës (me ndërhyrjen e Prokurorit të Rrethit Elvin Gokaj) kërkoi nga gjykata të caktohet masa e sigurimit detyrim paraqitje, kur kjo veprë akuzohej në bashkëpunim dhe kishte rrezikshmëri të veçantë të dy të pandehurit. Gjykata Elbasan me vendimet penale numër ***, datë 02-12-2012 dhe numër ***, datë 02-12-2012 i caktoi këtë masë sigurimi për të pandehurit. Prokurori i Rrethit Elvin Gokaj, nuk ndërhyr për të kërkuar në gjykatë masë paraburgimi për këta të pandehur ose për të bërë ankim në Apel.”

Nga analiza e fashikujve penalë, ka rezultuar se:

Prokuroria arsyeton kërkesat e saj për caktimin e masës së sigurimit “detyrim paraqitje” për dy personat e mësipërm: “Është fakt se duke vlerësuar provat e grumbulluara deri në këtë fazë të hetimeve paraprake ekziston një dyshim i arsyeshëm dhe i mbështetur në prova se personi nën hetim ka konsumuar elemente të veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal.”

Bazuar në arsyetimin e prokurorit të çështjes, lloji i masës së sigurimit të kërkuar nuk përputhet me arsyetimin e dhënë prej tij.

Për sa më sipër Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë nuk ka konstatuar se kërkesa e prokurorit të çështjes për caktimin e masës së sigurimit personal “detyrim paraqitje” ishte e paargumentuar.

Në lidhje me këtë konstatim, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit, i cili, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, ka sqaruar se:

*“Përfundimisht prokurori ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, pasi ka informuar gjykatën se nga aktet e ekspertimit të administruara ka rezultuar se pesha e materialit bimor pa ambalazh për shtetasin E.D. është 3.04 gram, me përqëndrim mesatar 13.8 % dhe se në mostrën e urinës së shtetasit E.D. u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të kanabinoideve. Nga Gjykata, me vendimin nr. *** datë 02.12.2012 është pranuar arsyetimi i prokurorit dhe caktimi i masës së sigurimit detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore, parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale.*

*E njëjta mënyrë veprimi në kërkesat për caktim mase sigurimi është ndjekur edhe për shtetasin R.T. ku nga akti i ekspertimit pesha e materialit bimor pa ambalazh është 7 gram, me përqëndrim mesatar 4.69 % dhe në mostrën e urinës së këtij shtetasi janë zbuluar prania e metabolizmit të kanabinoideve. Gjykata me vendimin nr. ***, datë 02.12.2012 ka pranuar kërkesën e prokurorit, duke e vlerësuar të drejtë dhe ka caktuar masën e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale.*

Parashtrova sa më sipër, me qëllim analizimin e gjetjeve të Komisionit.

Nga ana e prokurorit fillimisht është kërkuar caktimi i masës së sigurimit arrest në burg për të dyshuarit, pasi nga të gjitha të dhënat e administruara deri në atë moment, ekzistonte dyshimi se ishte konsumuar vepra penale e prodhimit dhe shitjes së narkotikëve parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale. Pasur parasysh rrezikshmërinë e kësaj vepre penale, është vlerësuar si masa më e drejtë.

Në lidhje me llojin e masës së kërkuar prej nesh dhe të gjendur të drejtë nga gjykata, arrest në burg, dua të theksoj se në masën e sigurimit, nuk nevojitet i njëjti nivel provash si në deklarinimin fajtor të një personi.

Përfundimisht, me administrimin e akteve të ekspertimit, nga prokurori është kërkuar caktimi i masës së sigurimit detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore, parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, për shkak se sasia e lëndës narkotike rezultoi e vogël, përqëndrimi i vogël, të dyshuarit rezultuan përdorues dhe nuk kishim të dhëna të qëndrueshme në atë moment nëse këta persona ishin të përfshirë në ndonjë aktivitet shpërndarje apo ishin thjesht përdorues. Pastaj, caktimi i masës së sigurimit detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore, mund të bëhet për shumë shkaqe, pasi mund të jetë pjesë e planit hetimor të prokurorit, me qëllim mbajtjen në vëzhgim të personave për të zbuluar nëse ekziston një aktivitet më i shtrirë kriminal dhe kush persona mund të jenë të implikuar. Këto plane hetimore për shkak të ruajtjes së sekretit hetimor jo gjithmonë gjenden të shkruara e të administruara në dosje për shkak të zbulimit të sekretit.

Sidoqoftë, duke pasur parasysh sasinë e vogël të lëndës narkotike të gjendur, faktin që këta shtetas rezultonin përdorues, mungesën e të dhënave për ndonjë aktivitet kriminal më të shtrirë të tyre si dhe moshën e tyre e re, është vlerësuar si masa më e përshtatshme.”

Komisioni pasi analizoi përgjigjen e subjektit vlerëson se ajo nuk është bindëse.

Në kërkesën për masën e sigurimit parashikohet se:

“Është fakt se duke vlerësuar provat e grumbulluara deri në këtë fazë të hetimeve paraprake ekziston një dyshim i arsyeshëm dhe i mbështetur në prova se personi nën hetim ka konsumuar

element të veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal.”

Mbështetur në kërkesën për masë sigurimi, si dhe provat e administruar rezulton se masa e sigurimit “detyrim paraqitje” nuk është e argumentuar, pasi nga analizimi i provave të administruara rezulton se nuk plotësohet kriteret e parashikuar nga neni 229 dhe 230 i K.Pr. Penale.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë duhej të kishte konstatuar mungesën e argumentimit të prokurorit të çështjes, duke treguar njohuri të cekëta dhe gjykim të dobët në analizimin e provave dhe argumentimin e masës së sigurimit konform neneve 229-230 të K.Pr. Penale si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij si drejtues i Prokurorisë, të cilat konsiderohen mangësi profesionale.

- g. Denoncuesi ka cituar se në kundërshtim me detyrat e tij si drejtues në prokurorinë Elbasan (në vitet 2008-2013) dhe në kundërshtim me nenin 24 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit nuk ka mbajtur qëndrim me vendim për të kundërshtuar veprimet e prokurorëve për pushimet e padrejta të çështjeve ose për mosfillimet e çështjeve, duke cituar rastet e mëposhtme:

i. Në procedimin penal numër * të vitit 2009 (me akuzën shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor)**

Nga fashikulli i procedimit penal rezulton se:

- Prokurori R. S., në datë 27.08.2009 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, i cili bën fjalë për veprën penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor të parashikuar nga neni 290/1 i K.Penal.
- Nga akti i ekspertimit autoteknik datë 06.03.2009 rezulton se shkak i ndodhjes së aksidentit ka qenë mosrespektimi i kërkesave të nenit 146/ pika 2, germa “a” dhe “b” dhe nenit 140/1 i Kodit Rrugor nga drejtuesi i motoçikletës, shtetasi M. A.
- Nga ana e organit të Prokurorisë nuk është marrë në pyetje shtetasi M. A. (i dëmtuar nga aksidenti) si dhe nuk është administruar asnjë dokument për të provuar nëse ky shtetas ka qenë i pajisur me leje drejtimi, nuk i është bërë ekspertiza mjeko-ligjor për të konstatuar nëse ai ka qenë duke drejtuar nën efektet e alkoolit.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë nuk ka konstatuar mangësitë në këtë hetim të paplotë, megjithëse ligji dhe aktet nënligjore⁹ e ngarkojnë me këtë detyrë.

Në lidhje me këtë konstatim, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit, i cili, pas dërgimit të rezultateve të hetimit ka sqaruar se:

“Ky material është mosfilluar me vendimin datë 20.03.2009 për shkak se mungon pasoja, dëmtimi i shtetasve. Megjithëse ngjarja ka ndodhur më datë 28.02.2009 materialet janë referuar në prokurori më datë 02.03.2009. Nuk ka asnjë të dhënë që të jetë njoftuar drejtuesi i Prokurorisë në lidhje me ngjarjen e ndodhur në momentin e ndodhjes.

Referuar gjetjeve të Komisionit nga ana ime duhet të ishte evidentuar se hetimi është i paplotë për shkak se shtetasit M. A. nuk i është bërë ekspertiza për të përcaktuar nëse ka qenë në efektin e alkoolit. Kjo gjë mund të evidentohet se ka qenë krejtësisht e pamundur referuar

⁹ Urdhër nr.***, datë 09.05.2008 dhe urdhër nr.***, datë 09.05.2008 i Prokurorit të Përgjithshëm.

kohës se kur është referuar ky material në prokurori dhe dijenisë sime në lidhje me momentin e marrjes dijeni për këtë material. Analizat e gjakut tregojnë për praninë e alkoolit brenda një kohe të shkurtër dhe sidomos varet nga sasia e alkoolit e konsumuar. Për më tepër, kur ky veprim nuk bëhet menjëherë nga policia, pas dy ditësh nuk mund të kryhet për shkak se personi mund të ketë konsumuar alkool pas ngjarjes dhe nuk do të kishim si ta evidentonim nëse ka qenë apo jo nën efektin e alkoolit në momentin e ngjarjes. Si një veprim i tillë, nuk kishte asnjë mundësi për t'u bërë më vonë ky veprim.

Në tërësinë e materialeve të trajtuara nga prokuroria, pasur parasysh problematikën e qarkut të Elbasanit, përparësinë që i jepet çështjeve, besueshmërinë dhe marrëdhëniet e bashkëpunimit me policinë gjyqësore, janë verifikuar materialet e sjella nga kjo e fundit, ku është referuar vepra penale vetëm për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor. Prezumohet se policia gjyqësore kur bën referimin e ka të qartë kuadrin e shkeljeve të ndodhura.”

Subjekti i rivlerësimit ka dhënë argumente, duke u mbështetur në faktin se referimi i ka ardhur nga policia gjyqësore dhe për këtë arsye, duke marrë në konsideratë dhe rëndësinë e veprës penale, janë mbështetur në raportet e policisë gjyqësore. Ndërkohë nga aktet në dosje rezultojnë mangësi në hetim, të cilat subjekti, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë, nuk i ka konstatuar. Bazuar në nenin 24 dhe 25 të K.Pr. Penale si dhe pikën 3 të urdhrit nr. ***, datë 09.05.2009 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në Prokurorinë e Shkallës së Parë” parashikohet se:

“Drejtuesit e prokurorive të shkallës së parë, para se të nënshkrujanë shkresat për kalimin e akteve të prokuroritë në gjykatë ose tek subjektet e tjerë të procedimit penal, para se të vendoset arkivimi i fashikujve të procedimeve penale të mosfilluara ose të përfunduara, si dhe para se të vendoset arkivimi i praktikave që ata kanë në ndjekje, kanë për detyrë të kontrollojnë bazueshmërinë në ligj të akteve dhe të procedimit penal. Ata marrin përgjegjësi për kontrollin e zgjidhjes ligjore dhe/ose formulimin e aktit nga prokurori më i ulët”.

Moskryerja e këtyre veprimeve hetimore, për sa kohë nuk është arritur të provohet se është bërë me qëllim favorizimin e ndonjë shtetasi nga subjekti i rivlerësimit, tregojnë njohuri dhe aftësi të cekëta për të hetuar të subjektit të rivlerësimit si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij si drejtues i Prokurorisë, të cilat konsiderohen mangësi profesionale.

ii. Në dosjen hetimore me numër vendimi pushimi * datë 11-5-2009 (me akuzën sipas nenit 259 të Kodit penal) .**

Nga fashikulli i procedimit penal rezulton se:

- Prokurori R. S., në datë 11.05.2009 ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. *** /2009 për veprën penale të “Korrupsionit pasiv” të kryer nga shtetas që ushtrojnë funksione publike.
- Në informacionin e dërguar nga ana e Drejtorisë së Policës së Qarkut Elbasan referohet se: “Shtetasja E. O., u merrte lekë studenteve për nota kaluese. Nga informacionet e marrë në rrugë operative tre studentë B. A., K. H., dhe A. R., i kishin dhënë para një studenti nga Kavaja për të kaluar në lëndën e shtetasës E. O. Në shumë raste kur ajo ka provim shoqërohet nga bashkëshorti i saj D. P.”

Rezulton se nga ana e prokurorit nuk janë marrë në pyetje në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale shtetasit B. A., K. H., dhe A. R., dhe as shtetasja E. O., për të cilën pretendohet se kjo shtetase u merrte lekë studenteve për nota kaluese. Nuk është kryer asnjë veprim hetimor për të verifikuar nëse këto shtetas kanë patur provim dhe kanë kaluar si dhe kush ishte studenti nga Kavaja.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë nuk ka konstatuar mangësitë në këtë hetim të paplotë, megjithëse ligji dhe aktet nënligjore¹⁰ e ngarkojnë me këtë detyrë.

Në lidhje me këtë konstatim, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit, i cili pas dërgimit të rezultateve të hetimit ka sqaruar se:

“Procedimi penal i mësipërm është bërë pas referimit të kryer nga policia gjyqësore. Policia gjyqësore ka parashtruar se të dhënat i ka siguruar nga informacione të marra në rrugë operative. Plani hetimor që është zbatuar në këtë rast, ka pasur të bëjë me përdorimin e mjeteve të posaçme të hetimit, konkretisht me realizimin e përgjimit. Nuk është bërë e mundur provimi i elementëve të veprës penale. Ndërkohë vijimi i hetimeve duke u pyetur personat të cilëve pretendohet se pedagogia u kishte marrë lekë, është vlerësuar të mos ezaurohej si veprim, në radhë të parë, pasi këta persona vetë nuk ishin paraqitur për të kallëzuar dhe nuk kishte pritshmëri për të mbledhur të dhëna prej tyre dhe në radhë të dytë, pasur parasysh faktin se OPGJ ka referuar se të dhënat janë marrë në rrugë operative, mund të dëmtoheshin informatorët e policisë. Për këtë arsye plani hetimor ka qenë që të procedohej me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit. Për më tepër, nuk kishte të dhëna mbi episode të evidentuara saktësisht në kohë, vend, mënyrë, mekanizëm etj. Korrupsioni është një çështje fakti ku vlerë kryesore merr kapja në flagrancë, me mjetin e kryerjes së veprës penale apo produktin të veprës penale. Këto vepra janë shumë të vështira për t’u provuar vetëm mbi deklaratime personash. Në raste të tilla është vlerësuar me vend të mos procedohej me hetime të hapura kur të dhënat nuk ishin të mjaftueshme sa të premtinin vazhdimësinë e procedimit në mënyrë që në sezon provimesh të ekzistonte mundësia për të nisur sërish procedim penal. Në rast se do të dilnim me hetim të hapur, do të digjnim këtë mundësi.”

Komision vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë bindëse, pasi siç rezulton më lart, çështja është pushuar dhe nuk kishte arsye që përpara se të vendosej pushimi të kryheshin dhe veprimet e tjera hetimore të nevojshme. Moskryerja e këtyre veprimeve hetimore, për sa kohë nuk është arritur të provohet se është bërë me qëllim favorizimin e shtetas E. O., nga subjekti i rivlerësimit, tregojnë njohuri dhe aftësi të cekëta për të hetuar të subjektit të rivlerësimit si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij si drejtues i Prokurorisë, të cilat konsiderohen mangësi profesionale.

iii. Në dosjen hetimore me numër vendimi pushimi *, datë 27-8-2009 (me akuzën sipas nenit 250 e 25 te Kodit Penal) .**

Nga analiza e fashikullit penal, rezulton se:

- Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm nëpërmjet deklarimit të shtetasit G. T., datë 26.05.2009 ora 11:30 është njoftuar mbi ngjarjen e ndodhur në datë 23.05.2009 (ditë e shtunë), e cila bën fjalë për shoqërimin në ambientet e komisariatit të këtij shtetasi ku ndaj tij është përdorur dhunë fizike dhe psikologjike nga specialisti i hetimit të krimeve të lehta B. Q.;
- Bazuar në aktin e ekspertimit mjeko-ligjor nr. ***, datë 27.05.2009 rezulton se ndaj shtetasit G. T., është ushtruar dhunë, pasi tek ai konstatohet: *enjtje e gjoksit të majtë, dhimbje të testeve dhe të gjoksit të majtë...dëmtimet hyjnë në kategorinë që kanë shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë deri në 9-ditë;*
- Bazuar në procesverbalin e të dhënave nga personat, të cilat kanë dijeni për veprën penale të shtetasit Q. H., me detyrë patrullë e përgjithshme në repartin e policisë pranë Komisarariatit Elbasan rezulton se: *Shtetasi G. T., nuk është regjistruar si i shoqëruar;*

¹⁰ Urdhër nr.***, datë 09.05.2008 dhe urdhër nr.***, datë 09.05.2008 i Prokurorit të Përgjithshëm.

- Bazuar në relacionin e OPGJ-së në të cilin janë analizuar dhe cituar provat e procedimit penal, rezulton se jemi në kushtet e kryerjes së veprës penale, të parashikuar nga neni 250 e 25 i K.Penal, kryer nga punonjësi i policisë së shtetit B. Q., dhe A. T.
- Prokurori R. S., në datë 27.08.2009 ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. *** /2009 për veprën penale “Kryerje e veprimeve arbitrare në bashkëpunim”;
- Së bashku me shtetasin B. Q., ka qenë dhe shtetasi A. T., me detyrë specialist për hetimin e krimeve të rënda në Komisarlatin e Policisë Kurbin në momentin që shtetasi G. T., ka qenë në zyrën e z. Q. Nga ana e prokurorit duhej të hetohej arsyeja se pse ky shtetas ka qenë prezent në zyrën e z. Q., gjatë kohës që ky i fundit po merrte në pyetje shtetasin G. T.;
- Nga ana e prokurorit duhet të hetohej se cila ka qenë arsyeja që z. G. T., është mbajtur në komisarlati pa u regjistruar si person i shoqëruar apo i ndaluar;
- Vendimi i pushimit është i paargumentuar, nuk përmenden dhe analizohen provat e administruara gjatë hetimit penal si dhe nuk jepet asnjë argument në lidhje me rezultatet e aktit të ekspertimit mjeko-ligjor nga ku është konstatuar se kallzuesi shtetasi G. T., ka pësuar dëmtime;
- Në këtë vendim prokurori deklaron se pas rreth pesë ditësh G. T., ka dhënë deklaram pranë SHKB-së ndërkohë që nga aktet e dosjes rezulton se ai e ka dhënë pas tri ditësh (në fakt pas një dite, pasi data 23-24 kanë qenë ditë e shtunë dhe e diel). Nga procesverbali mbi marrjen e të dhënave nga persona të cilat kanë dijeni për veprën penale të datës 27.05.2009 rezulton se babai i z. G.T., ka deklaruar se është paraqitur në prokurori që të hënën më datë 25, por i kanë thënë që të paraqitet në SHKB.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë nuk ka konstatuar shkeljet procedurale dhe mangësitë në këtë hetim të paplotë, megjithëse ligji dhe aktet nënligjore¹¹ e ngarkojnë me këtë detyrë.

Në lidhje me këtë konstatim, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit, i cili, pas dërgimit të rezultateve të hetimit ka sqaruar se:

*“Në lidhje me këtë procedim penal, parashatroj se nga opgj pranë SHKB-së është bërë këqyrja e bllokut të lejeve të hyrjes për në Komisarlatin e Policisë dhe në fletën nr. *** është shënuar emri i shtetasit G.T., dhe fakti që lejohet të takohet me *** B.Q., datë 23.05.2009.*

Në lidhje me arsyen përse shtetasi A.T. ka qenë në zyrën e shtetasit B.Q., është sqaruar nga vetëdeklarimi i shtetasit A.T. pasqyruar në procesverbalin e datës 29.05.2009. Shtetasi A.T., punonjës policie dhe mik me punonjësin e policisë B.Q., është lejuar nga ky i fundit të hyjë në zyrën e tij.

Fakti që pretendohet prej Komisionit se përse prokurori ka thënë se pas rreth pesë ditësh shtetasi G.T. ka dhënë deklaram pranë SHKB-së, nuk ka ndonjë vlerë arsyetuese në vendimmarrje dhe nuk rezulton nga përmbajtja e vendimit të jetë bërë me ndonjë qëllim keqdashës.

Në lidhje me deklaramin e datës 27.05.2009, të dhënë nga shtetasi A.T., ku sipas tij ai është interesuar për t’u ankuar në prokurori dhe atje i kanë thënë që duhet të vesh tek SHKB, siç mund të konstatonin nuk është identifikuar asnjë person se tek cili është paraqitur. Nuk rezulton i dokumentuar paraqitja e këtij shtetasi në Prokurori dhe mosmarrja e ankimit të tij. Ai mund të jetë interesuar, duke nisur që nga roja i shërbimit tek dera.

¹¹ Urdhër nr. *** datë 09.05.2008 dhe Urdhër nr.*** datë 09.05.2008 i Prokurorit të Përgjithshëm

Në lidhje me pretendimet që parashtroni, për datat 23 dhe 24 se kanë qenë ditë pushimi, nuk përbëjnë asnjë të dhënë relevante, pasi edhe në ditë pushimi si policia ahstu edhe prokuroria kanë njerëz të gatshëm në detyrë.

Kjo vendimmarrje ka qëndruar në fuqi dhe nuk është ankimuar.”

Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë bindëse dhe nuk mbështeten në prova.

Në këtë procedim nga ana e tij në cilësinë e drejtuesit të organit të akuzës duhej të konstatoheshin mangësitë në këtë procedim dhe t'i kërkohej prokurorit të çështjes plotësimi i tyre. Në përfundim, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit sërish ka shfaqur njohuri dhe aftësi të cekëta si dhe gjykim të dobët për kryerjen e procedurave dhe veprimeve të nevojshme hetimore me qëllim vendosjen përpara drejtësisë të personave që kanë kryer vepra penale si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij si drejtues i Prokurorisë, të cilat konsiderohen mangësi profesionale.

Në përfundim, pasi shqyrtoi dhe analizoi të gjithë dokumentacionin e administruar, si dhe shpjegimet e provat e paraqitura nga subjekti, në lidhje me këtë kriter Komisioni vlerëson se

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në disa raste ka rezultuar se ai ka aftësi dhe njohuri të cekëta në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit penal dhe procedural penal në fuqi, si dhe ka shfaqur gjykim të dobët. Rezulton se subjekti ka njohuri të cekëta, gjykim të dobët si dhe një mënyrë punë që nuk pajtohet me pozicionin e tij si drejtues i Prokurorisë në lidhje me kryerjen e procedurave dhe veprimeve të nevojshme hetimore, të cilat janë evidentuar nga ana e Komisionit në çdo procedim të trajtuar më lart. Për më tepër subjekti nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve ose viktimave, të paktën në një rast, të trajtuar më lart.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit ka mangësi profesionale në arsyetimin ligjor. Në disa raste rezulton se nga ana e tij analiza e figurës së veprave penale, masa e dënimit të kërkuar, kërkesa për caktimin e masës së sigurimit, rezultojnë të paargumentuar, nuk përputhen me provat e administruara si dhe me kriteret e parashikuara nga legjislacionin procedural penale.

2. Aftësitë organizative

Bazuar në të dhënat e deklaruara nga subjekti në formularin e vetëvlerësimit rezulton se subjektit i janë caktuar gjatë periudhës së punës për vitet 2014, 2015 dhe 2016, në total 1049 çështje, nga të cilat janë çështje në themel, masa sigurimi dhe çështje të tjera.

Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në shortin e zhvilluar në datën 28.12.2017 në Prokurorinë e Apelit Shkodër për përzgjedhjen e pesë dosjeve për periudhën e vlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, rezulton se afatet kohore të trajtimit të tyre, janë të shpejta në raport me natyrën dhe kompleksitetin e tyre. Nga analiza e rasteve më lartë ai nuk është efektiv.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Nga verifikimi pranë sektorit të burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme rezultoi se për periudhën e vlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, ndaj subjektit nuk është marrë asnjë masë disiplinore. Bazuar në të gjitha burimet e informacioneve nuk rezultojnë të dhëna apo elemente për të konkluduar rreth cenimit të integritetit të tij apo paanësisë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve të ngarkuara. Pranë Komisionit janë paraqitur tri ankesa, të cilat janë hetuar dhe vetëm njëra ka rezultuar se ka patur fakte, të cilat pasi janë hetuar, kanë shërbyer si prova për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Nga vlerësimet e punës së subjektit prokuror Elvin Gokaj për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar *“shumë mirë”*.

Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e vlerësimit profesional, Komisioni çmon se subjekti ka shfaqur njohuri, aftësi dhe gjykim të cekët në punën profesionale të tij si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij si drejtues i Prokurorisë, si më poshtë vijon:

- Në tetë raste, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka treguar njohuri dhe aftësi të cekëta dhe gjykim të dobët për kryerjen e procedurave dhe veprimeve të nevojshme hetimore;
- Në dy raste, Komisioni ka konstatuar njohuri të cekëta të subjektit të rivlerësimit në lidhje me figurën e veprës penale;
- Në tre raste, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur njohuri të cekëta dhe gjykim të dobët për analizimin e masës së dënimit të kërkuar;
- Në tre raste, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka shfaqur njohuri të cekëta dhe gjykim të dobët në lidhje me analizimin e provave të administruara;
- Në dy raste, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur njohuri të cekëta dhe gjykim të dobët në analizimin e provave dhe argumentimin e masës së sigurimit konform neneve 229-230 të K.Pr.Penale;
- Në një rast, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur njohuri të cekëta në lidhje me të drejtat e të pandehurit dhe mbrojtësit të tij.
- Në 10 raste, Komisioni ka konstatuar një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij si drejtues i Prokurorisë.

Pavarësisht pozicionit të tij si drejtues prokurorie dhe shpjegimeve të tij për përgjegjësi të prokurorit dhe jo drejtuesit, Komisioni konkludon se subjekti ka patur detyrimin ligjor të thellohej në arsyetimin e vendimeve, të kontrollonte lidhjen logjike të argumentave me kërkesat e prokurorëve përpara gjykatës si detyrim ligjor i përcaktuar nga ligji procedural penal dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

KONKLuzioni Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë dhe një nivel të besueshëm të kontrollit

të figurës. Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni ka konstatuar mangësi në aftësitë e tij profesionale, të cilat mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “b”, nenit 44/b, si dhe të nenit 60, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë,

V E N D O S I:

1. Pezullimin nga detyra të zotit Elvin Gokaj për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 24.07.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila PINE
Kryesuese
(kundër)

Pamela QIRKO
Anëtare

Genta Tafa (Bungo)
Relatore

Sekretare gjyqësore
Fiorela Mandro

MENDIM PAKICE

Unë, komisionere Xhensila Pine, kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues, për pezullimin nga detyra për një periudhë 1-vjeçare, për subjektin e rivlerësimit, z. Elvin Gokaj, prokuror/drejtues në Prokurorinë e Apelit Shkodër, me detyrimin e ndjekjes prej tij të programit të trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.

Kundërshtitë e mia kanë të bëjnë me vlerësimin e të tria kritereve: të pasurisë; të figurës; dhe të vlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit, z. Elvin Gokaj për sa më poshtë vijon:

A. Në lidhje me vlerësimin e pasurisë

1.Për apartament banimi me sip. 76 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z.k. ***, Durrës, subjekti ka deklaruar si burim krijimit në deklaratën “Vetting”: kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes.

2.Pagesa e këstit të dytë të këtij apartamenti prej 10.000 euro, në datën 30.5.2014, është bërë nga subjekti nëpërmjet huas së marrë shtetasit E.N., në po të njëjtën datë sipas aktmarrëveshjes së nënshkruar mes palëve.

3.Referuar “rezultateve të hetimit administrativ”, Komisioni, bazuar në pikën 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për mosdeklarimin në deklaratën “Vetting”, si burim krijimi të huas së marrë shtetasit E.N.

4.Subjekti në përgjigje të barrës së provës ka shpjeguar se burimi i krijimit për këtë apartament nuk është huaja e marrë nga z. E.N., por pagat dhe depozita bankare e tij. Sipas subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting” janë kërkuar detyrimet ndaj të tretëve, çka në rastin e tij e konsideron se nuk ka pasur të tilla.

5.Trupi gjykues, në vlerësim të të gjithë situatës, në kuadër të hetimit të thelluar, dhe të shpjegimeve të subjektit në raport me legjislacionin e zbatueshëm, arsyeton se:

5.1 Në lidhje me mosdeklarimin e huas si burim në deklaratën “Vetting” për pagesën e këstit të dytë subjekti i rivlerësimit ka qenë bindës në shpjegimet e tij duke argumentuar se burimi real kanë qenë të ardhurat e tij nga depozita në “Credins Bank”. Rezulton se subjekti i rivlerësimit ka marrë një hua të cilën e ka shlyer brenda të njëjtit vit kalendarik, menjëherë pas maturimit të depozitës së tij në “Credins Bank”. Pra, që në origjinën e blerjes së këtij apartamenti burimi i të ardhurave ka qenë depozita në “Credins Bank”, e cila është maturuar 7-muaj pas pagesës së këstit të dytë. Kjo hua bazuar në ligjin nr. 9367, nuk ka qenë e detyruar për t’u deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike pasi është shlyer brenda vitit me të ardhurat e subjektit të rivlerësimit”.

5.2“Në deklarimin e parë në datën 29.12.2005, z. E.N., deklaroi para cash në vlerën 10.000.000 lekë, me pjesë zotëruese 25 %, të deklaruara të krijuara ndër vite, dhe detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë në vlerën 0 lekë. Për vitet në vazhdim deklarohen para cash (pa specifikuar shtesa nga viti i kaluar apo gjendje në banesë në fund të periudhës). Nga hetimi ka rezultuar se shtetasi E.N., ka pasur aftësi financiare për dhënien e kësaj huaje.

6.Për sa ka argumentuar shumica e trupit gjykues paraqes argumentet e mia për votën time kundër

6.1 Subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë plotësuar në mënyrë të saktë dhe të plotë dhe në përputhje me kërkesat e nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016 dhe me rregullat e udhëzimit

nr. 4095 të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, të deklaratës së pasurisë (vetting) 2017, të dhënat për z. E.N., lidhjen e këtij të fundit me subjektin, si dhe llojin e interesave privatë dhe vendndodhjen e tyre.

6.2 Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë (vetting) 2017, janë kërkuar detyrimet ndaj të tretëve, çka në rastin e tij e konsideron se nuk ka pasur të tilla, nuk qëndron, pasi referuar legjislacionit të posaçëm të procesit të rivlerësimit dhe rregullave të detajuara të mënyrës së plotësimit të deklaratës së pasurisë vetting, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të plotësonte të dhënat për çdo pasuri në pronësi, burimin në momentin e krijimit, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri në momentin e fitimit të tij.

6.3 Më konkretisht, në deklaratën e pasurisë vetting, burimet e krijimit të pasurisë janë objekt shprehimisht i përfshirë ndër detyrimet e subjekteve, si dhe pjesë e trajtuar në mënyrë të shprehur në përshkrimin e atyre pasurive.

6.4 Pika 6 e udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, parashikon: “Persona të tjerë të lidhur, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, [...], që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit [...] që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi. Kur subjekti i rivlerësimit deklaronte këto lloje marrëdhëniesh juridike me persona të tjerë të lidhur, ai mbart detyrimin të paraqesë dokumentacionin justifikues ligjor, në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, për pronësinë dhe burimin e krijimit të pronës.

6.5 Në zbatim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, dhe udhëzimit nr. 4095/2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të deklaronte këtë hua nga shtetasi E.N., si burim në momentin e krijimit të kësaj pasurie, si dhe të justifikonte ligjshmërinë e krijimit të shumës së dhënë hua nga shtetasi E.N., me dokumentacion ligjor provues.

6.6 Deklarimet e gjendjes cash në deklarimet periodike vjetore të pasurisë të huadhënësit, z. E.N., nuk provojnë, se z.E.N., ka pasur të ardhurave të ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, për krijimin e shumës dhënë hua prej 10.000 euro.

6.7 Në përfundim, për sa më sipër arsyetuar, arrij në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm, për krijimin e kësaj pasurie, parashikuar nga pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe ka kryer deklarim të pasaktë, parashikuar nga neni D, pikat 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës.

7.Në lidhje me lëvizjet monetare në llogaritë dyemërore të bashkëshortes së subjektit, znj. R.G.:

7.1 Llogaria nr. *** në euro, në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit është hapur më 29.5.2012, duke derdhur *cash* në depozitë shumën 5.000 euro, shumë e cila në datën 29.5.2013 është transferuar në llogarinë dyemërore nr. *** në euro, të S.G., ose R.G.

7.2 Nga llogaria nr. *** në euro, e S.G., ose R.G., në datën 30.5.2013, llogaria nr. *** në euro, në emër të bashkëshortes së subjektit në “Credins Bank” është kredituar shuma 6.000 euro, me përshkrim – kalim në depozitë 12 mujore.

7.3 Nga llogaria e përbashkët nr. *** në lekë, e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit me nënën e saj, znj. L.P., është transferuar në datën 14.8.2013, shuma 1,010,010.72 lekë, në llogarinë e përbashkët nr. *** në emër të S.G., ose Rr.G.

7.4 Referuar “rezultateve të hetimit administrativ”, Komisioni, bazuar në pikën 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për mosdeklarim të transfertave bankare të kryera nga bashkëshortja e tij duke i kërkuar të qartësojë arsyen e transferimit të shumës 1,010,010.72 lekë nga llogaria e përbashkët e bashkëshortes me nënën e saj, tek llogaria e përbashkët e bashkëshortes me nënën e tij.

7.5 Në përgjigjet pas kalimit të barrës së provës në lidhje me lëvizjet monetare në llogaritë dyemërore të Rr.G./S.G., ose Rr.G./L.P., subjekti ka shpjeguar: “Çdo llogari bankare e çdo lloj banke që operon në Shqipëri, ku titullar i kontratës me bankën është nëna ime S.G., janë kursimet e prindërve të mi me të ardhurat ndër vite që kanë përfituar në Itali...bashkëshortja ime ...nuk ka pasur asnjë rast të derdhjes apo tërheqjes së kapitalit pa praninë e nënës sime”.

8. Trupi gjykues, në vlerësim të të gjithë situatës në kuadër të hetimit të thelluar, dhe të shpjegimeve të subjektit në raport me legjislacionin e zbatueshëm, arsyeton se:

8.1 Nga hetimi administrativ ka rezultuar se mbajtësit e llogarive, prindërit e tij, si dhe nëna e bashkëshortes së tij, kanë vërtetuar me dokumentacion provues aftësinë financiare të tyre për të hapur këto depozita, dhe rrjedhimisht, nuk lindin dyshime që këto llogari të kenë si burim të ardhura të krijuara në mënyrë të paligjshme nga subjekti i rivlerësimit.

8.2 Nga analizimi i dokumentacionit të administruar dhe shpjegimeve të subjektit rezulton se ai ka qenë i saktë në deklaratën “Vetting” pasi llogaritë dyemërore janë mbyllur gjatë vitit 2016 dhe se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrimin ligjor për të deklaruar këtë llogari.

9. Për sa ka argumentuar shumica e trupit gjykues paraqes argumentet e mia për votën time kundër

9.1 Shpjegimet e dhëna nga subjekti për këto llogari dyemërore, vijnë në kundërshtim me legjislacionin bankar në fuqi. Nëse nëna e subjektit dhe nëna e bashkëshortes së tij, do të kishin fondet e tyre në llogaritë bankare që dispononin, ato do të ishin mbajtëset e llogarive bankare në emër të tyre. Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, si personi i besuar i tyre, do pajisej me autorizimin, që i jepte të drejtën të kryente veprimet në kuadër të nivelit të autorizimit të caktuar, sipas njoftimit të autorizimit të bërë nga palët për bankën personalisht ose me akt noterial.

9.2 Nga hetimi administrativ, ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit nuk ishte personi i autorizuar në këto llogari bankare, por ishte bashkëmbajtëse e këtyre llogarive dyemërore me nënën e saj dhe me nënën e subjektit të rivlerësimit.

9.3 Referuar legjislacionet bankar, të dy mbajtësit e llogarisë apo të depozitës prezumohet se janë bashkëzotërues të fondeve të këtyre llogarive dhe kanë të njëjtën mundësi për pranim apo dërgim mjjetesh monetare përmes depozimeve, tërheqjeve, e transfertave të këtyre fondeve të përbashkëta.

9.4 Shpjegimi i subjektit se në konsultim me punonjësit e bankës nuk ka asnjë rast për transfertat bankare nga llogaritë e depozitave dyemërore, bie ndesh me sa ka rezultuar nga hetimi administrativ, ku është konfirmuar transferimi i shumës 1,010,010.72 lekë nga llogaria

e dyemërore e bashkëshortes me nënën e saj, te llogaria dyemërore e bashkëshortes me nënën e subjektit.

9.5 Deklaratat noteriale përkatëse të bashkëtitullareve të llogarive dyemërore, paraqitur në datë 11.12.2018, nuk mund të shërbejnë si provë për të provuar se kapitali i depozituar, në të gjitha rastet, është i bashkëtitullareve S.G., ose L.P., dhe në asnjë rast i bashkëshortes së subjektit për sa kohë parashikimet ligjore bankare të vlerësimit të identitetit të klientit, përcaktojnë se të dy mbajtësit e llogarisë apo të depozitës prezumohet se janë bashkëzotërues të fondeve të këtyre llogarive.

9.6 Transaksionet kryer nga bashkëshortja e subjektit në këto llogari dyemërore, kanë shmangur detyrimin për deklarim të tyre dhe të burimit të tyre, në deklaramet periodike vjetore, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklaramet dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”

9.7 Mosdeklarimi i këtyre transaksioneve dhe të burimit të këtyre likuiditeteve nga bashkëshortja e subjektit në Vetting, passjell mosplotësim të saktë të formularit “deklarimi i pasurive”, miratuar si shtojcë 2, e ligjit nr. 84/2016, ku përcaktohet qartësisht se objekt i deklaramet janë të gjitha pasuritë e akumuluar ndërr vite, deri në ditën e dorëzimit të deklaramet së pasurisë.

Në referencë të pikave 1 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklaramet të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë.

B. Në lidhje me kontrollin e figurës

10.Paragrafi 2, i neni DH, të Aneksit të Kushtetutës, parashikon: “*Subjektet e rivlerësimit plotësojnë dhe i dorëzojnë Komisionit një deklaramet të detajuar për figurën e tyre, që mbulon periudhën nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklaramet sipas ligjit*”.

10.1 Subjekti i rivlerësimit konfirmuar me shpjegimet e sjella në Komisionit ka pasur një marrëdhënie huamarrje dhe marrëdhënie miqësore me shtetasin E.N. Në pyetësorin nr. 2, datë 20.9.2018, subjekti ka konfirmuar dijeninë e tij për procedimin penal nr. ***, të vitit 2014 ku shtetasi E.N., akuzohej për veprën penale “shpërdorim detyrë”.

10.2 Gjatë këtij procedimi është vendosur ndarja e procedimit penal nr. ***, të vitit 2014 në atë me nr. *** për veprën penale “pastrim i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, e subjekti i rivlerësimit nuk ka mospërmbushur detyrimin ligjor të deklaramet të kontaktit të papërshtatshëm me shtetasin shtetasin E.N., bazuar në nenin 38, të ligjit nr. 84/2016.

Në referencë të pikës 4, të nenit DH, të Aneksit të Kushtetutës, dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklaramet të pamjaftueshëm për kriterin e figurës.

C. Në lidhje me vlerësimin profesional

Jam pajtuar me gjetjet e Komisionit, por kam ndarë mendim të ndryshëm nga shumica në lidhje me mangësitë e konstatuara në këtë kriter, por referuar rëndësisë, shpeshësisë dhe tipologjisë së shkeljeve të konstatuara, kam vlerësuar se ato nuk mund të korrigjohen përmes programit njëvjeçar të edukimit në Shkollën e Magjistraturës.

Në përfundim për sa më sipër, në referencë të pikës 4, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, dhe të pikës 4, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e papërshtatmërisë nga vlerësimi i aftësive profesionale.

Në lidhje me vendimmarrjen e shumicës së trupit gjykues, duke marrë në konsideratë edhe arsyetimin dhe konkluzionet e mia në lidhje me kriterin e pasurisë, të figurës dhe atë profesional, jap votën time kundër, duke votuar për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, z. Elvin Gokaj, prokuror/drejtues në Prokurorinë e Apelit Shkodër, bazuar në pikën 3 dhe 4, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

ANËTARE /KUNDËR

Xhensila PINE